



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

# **Komisioni i Pavarur për Media**

## **Raporti Vjetor 2006**

**drejtuar**

**Kuvendit të Kosovës**

**28 shkurt 2007**

**Telefoni: 038 245 032**

**Telefaksi: 038 245 034**

**Web faqja: [www.imc-ko.org](http://www.imc-ko.org)**

**E-mail: [info@imc-ko.org](mailto:info@imc-ko.org)**

## Përmbajtja:

Parathënie .....	4
Baza ligjore e KPM-së .....	5
Tranzicioni nga Komisioneri i Përkohshëm për Media në Komisionin e Pavarur për Media .....	5
Komisioni i Pavarur për Media .....	6
Këshilli i KPM-së .....	7
Realizimi i detyrave të këshillit në bazë të ligjit .....	8
Zyra e Shefit Ekzekutiv .....	9
Aktivitetet e zyrës së Shefit Ekzekutiv .....	10
Rastet e procesuara nga divizioni ligjor .....	10
Rastet e procesuara nga divizioni i licencimit .....	13
Rastet e proceduara nga divizioni i menaxhimit të frekuencave (DMF) .....	18
Projektet e divizionit të monitorimit .....	20
Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente zyrtare .....	21
Bashkëpunimi me organizatat tjera .....	20
Pasqyra e buxhetit të KPM-së për vitin 2006 .....	23
Skemat organizative .....	24
Shtojca I	
a. Politika e Transmetimit.....	26
b. Udhëzimet e KPM-së për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve .....	28
Shtojca II	
a. Kodi i Sjelljes për Mediat Elektronike .....	33
b. Udhëzuesi për të Drejtën e Autorit .....	37
c. Kualifikimet për Licenca .....	41

### Shtojca III

a. Memorandumi Shpjegues .....	45
b. Çertifikata .....	51
c. Kushtet dhe termet e përgjithshme .....	52
d. Kushtet dhe termet teknike .....	60
e. Programi .....	67
f. Zona e mbulimit e licencës e paraqitur në hartë .....	69

## PARATHËNIE

Viti 2006 ishte viti më i rëndësishëm për rregullatorin e transmetimit, që nga viti 2000 kur u themelua fillimisht si Komisioner i Përkohshëm për Media. Me krijimin e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media në gjysmën e dytë të vitit 2006 filluan ndryshimet e mëdha me çka filloi edhe realizimi i bartjes së kompetencave nga ndërkombëtarët tek kosovarët. Ky ishte hapi i parë drejt përmbushjes së obligimeve të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës një vit më parë.

Këshilli i KPM, si organ vendimmarrës i përbërë nga shtatë anëtarë u themelua më 28 gusht 2006. Themelimit të Këshillit i parapriu një procedurë demokratike nominimi e përcaktuar me Ligj. Këshilli është përgjegjës për krijimin dhe ndryshimin e politikave të transmetimit të cilat duhet të jetë në përputhje me standardet më të mira të pranura ndërkombëtarisht si dhe në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin përkatës të Kosovës. Që nga themelimi tij Këshilli ka filluar të punojë në hartimin e legjislacionit dytësor dhe tanimë ka arritur që të miratojë një pjesë të politikave kyçe të cilat do të kontribuojnë në sigurimin e një mjedisi të shëndoshë për mediat elektronike në Kosovë. Pjesa tjetër mbetet të realizohet në vitin vijues me procesin e ri-licencimit, fillimin e rregullimit të transmetimit përmes rrjetit kabllor si dhe me planifikimin që Kosova të kalojë në përdorimin e teknologjisë së re – digjitalizimin – duke ecur në hap me vendet e tjera.

Krijimi i bazës së fortë ligjore nga Këshilli dhe promovimi dhe zbatimi i saj nga Komisioni i Pavarur për Media si tërësi do të ndikojë që mediat publike dhe private të zhvillohen profesionalisht, dhe financiarisht të jenë të sigurta. Komisioni do të përkujdeset që të gjitha subjektet transmetuese respektojnë të drejtat për shprehje të lirë të mendimit, për drejtësi dhe saktësi; që të krijohet vetëdija e mbrojtjes së interesave të fëmijëve dhe të drejtat e pakicave dhe kulturave të ndryshme.

Gjatë realizimit të misionit të vet, Komisioni i Pavarur për Media punon dhe do të vazhdojë të punojë në mënyrë transparente dhe konsultative me qëllim të përfshirjes së publikut dhe subjekteve transmetuese në procesin e zhvillimit të një sektori të mirëfilltë medial.

Me kënaqësi po e fillojmë përmbushjen e obligimeve tona ndaj Ligjit me prezantimin e raportit vjetor për herë të parë para Kuvendit të Kosovës dhe kam nderin që këtë e bëj në cilësinë e Shefit të parë Ekzekutiv Kosovar të këtij institucioni.

*Shkurt 2007*

**Naile Selimaj Krasniqi**  
**Shefe Ekzekutive e Komisionit të Pavarur për Media**

## **BAZA LIGJORE E KPM-së**

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ishte shpallur nga PSSP-ja më 8 korrik 2005 me rregulloren Nr. 2005/34. Ligji për KPM-në ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Këshilli i KPM-së nxjerr akte, udhëzime, politika dhe detyra të cilat janë të domosdoshme për zbatimin efektiv të këtij ligji. Deri më tani Këshilli i KPM-së ka lëshuar Politika e Transmetimit, Udhëzimet e KPM-së për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve, Politika e Këshillit të KPM-së në hartimin publik të rregullave dhe ka nxjerr një Kod të Etikës i cili është i aplikueshëm për Këshillin dhe personelin e Komisionit.

Kodi i Sjelljes për Mediat Elektronike, Udhëzuesi për të Drejtën e Autorit, Kualifikimet për Licenca si dhe dokumentet tjera të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm për Media vazhdojnë të mbesin në fuqi deri në amendamentimin, zëvendësimin ose shfuqizimin e tyre nga Këshilli i KPM-së.

### **TRANZICIONI NGA KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA NË KOMISIONIN E PAVARUR PËR MEDIA**

Në qershor të vitit 2000, me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/36 dhe Rregulloren Nr. 2000/37 UNMIK-u zyrtarisht e themeloi institucionin e Komisionerit të Përkohshëm për Media (KPM) për t'i rregulluar mediat transmetuese dhe - deri në një masë të kufizuar – edhe mediat e shkruara në Kosovë, duke i dhënë kështu KPM-së përgjegjësinë e promovimit të mediave të pavarura dhe profesionale në Kosovë, përmes një "regjimi rregullativ të përkohshëm për të gjitha mediat në Kosovë. KPM-ja ka lëshuar Licencat për transmetim, ka formuluar kodet e sjelljes së mediave dhe ka përpiluar rregullat për mbulimin elektoral. KPM-ja gjithashtu ka lëshuar shpjegime udhëzuese, formulime të politikave si dhe raporte të ndryshme për aktivitetin e mediave në Kosovë.

Me themelimin e Këshillit për Mediat e Shkruara, në vitin 2005, Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media pushoi të ketë autoritet në rregullimin e mediave të shkruara. Korniza Kushtetuese e Kosovës parashihte themelimin e Komisionit të Pavarur për Media, një organizatë plotësisht e pavarur në mesin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës aprovoi Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ishte shpallur nga PSSP-ja më 8 korrik 2005 me rregulloren nr. 2005/34. Ligji për KPM-në ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005, mirëpo autoriteti i Komisionerit të Përkohshëm për Media vazhdoi të mbetet në fuqi deri në muajin gusht 2006, kur u konstituua Këshilli i KPM-së.

Më 15 mars 2006, Komisioner i Përkohshëm për Media z. Robert Gillette përfundoi misionin 32 mujor në Kosovë. Pas largimit të Komisionerit Gillette PSSP-ja emëroi z. Eberhard Laue përkohësisht si Komisioner i Përkohshëm për Media. Në përpyetje për të kosovarizuar institucionet e Kosovës, më 4 korrik 2006, PSSP-ja emëroi z. Isuf Berisha si Komisioner të parë vendor të Përkohshëm për Media, mandati i të cilit përfundoi me konsituimin e Këshillit të KPM-së më 28 gusht 2006. Konstituimit të Këshillit të KPM-së i parapriu një proces i ndërmarrë nga Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media (ZKPM) duke filluar me ftesën për nominime. Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media filloi procesin e nominimit më 22 shtator 2005. Pas përfundimit të këtij procesi brenda afatit prej 30 ditë, ZKPM-ja për Kuvendin përzgjodhi tetë të nominuar të cilët përmbushnin kriteret e caktuara me ligj. Këto nominime i janë dërguar Komisionit Ad Hoc të Kuvendit në dhjetor 2005. Ky Komision përbëhej nga 17 anëtarë të cilët

përfaqësonin secilën parti që është e përfaqësuar në Kuvend dhe të cilët zgjodhën katër nga tetë kandidatët e paraqitur nga ZKPM.

Në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 27 prill 2006, zyrtarisht u ratifikua zgjedhja e katër personave nga Komisioni Ad Hoc të nominuar nga shoqëria civile. Anëtari i pestë, u caktua dhe u emërua nga Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 28 korrik 2006. Dy anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit të KPM-së janë emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë.

Me emërimin e anëtarëve të Këshillit të KPM-së përfundoi procesi i tranzicionit të Komisionerit të Përkohshëm për Media në Komisionin e Pavarur për Media , një agjenci e përhershme vendore, trashëgimtare ligjore e Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm për Media e cila ka rregulluar transmetimin që nga qershori i vitit 2000.

## **KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë. Qëllimi i një rregullatori për transmetim është të ndaj një burim të kufizuar – brezin frekuencor – në mënyrë të drejtë dhe të hapur për t'iu shërbyer më së miri të gjithë njerzëve në Kosovë. KPM-ja promovon standarde etike dhe teknike për mediat transmetuese në Kosovë. Zbaton një grup rregulloresh që i mban subjektet lokale transmetuese në nivel me standardet evropiane të profesionalizmit dhe paanësisë në mbulimin e lajmeve të tyre. Përmes administrimit të planit të tij frekuencor të transmetimit, KPM-ja gjithashtu përpiqet të jetë i paanshëm në konkurimin në mes të subjekteve transmetuese. Aktivitetet e KPM-së përfshijnë monitorimin e mbulimit e ngjarjeve aktuale të transmetuara, komentimet rreth legjislacionit që ka të bëjë me media, vlerësimin e ankesave, dhe zbatimin e rregulloreve dhe kushteve të licencave të lëshuara nga KPM-ja.

KPM-ja inkurajon zhvillim të fuqishëm, profesional dhe financiarisht të sigurt të mediave publike dhe private. Duhet të siguroj që mediat respektojnë të drejtat e njerzëve për shprehje të lirë dhe shumëllojshmëri të opinioneve, për paanësi dhe saktësi, jo vetëm në lajme por edhe në reklama. KPM-ja gjithashtu siguron se mediat mbrojnë interesat dhe ndjeshmërinë e fëmijëve, të drejtat e pakicave dhe kulturave të ndryshme që e bëjnë Kosovën një vend unik në Evropë. Dhe KPM-ja duhet ta bëjë tërë këtë me një punë të hapur dhe mënyrë konsultative që siguron respekt si nga publiku ashtu edhe nga subjektet transmetuese.

KPM-ja përbëhet nga tre trupa të veçantë:

- Këshilli
- Zyra e Shefit Ekzekutiv, dhe
- Bordi i Mediave për Ankesa

## KËSHILLI I KPM-së

Këshilli i KPM-së u konstituua më 28 gusht 2006. Është organi vendimmarrës i Komisionit të Pavarur për Media, dhe ka autoritetin e plotë të nxjerr akte, udhëzime, politika dhe detyra të cilat janë të domosdoshme për zbatimin efektiv të ligjit për KPM-në.

Anëtarë të Këshillit të KPM-së janë: Isuf Berisha, kryesues, Milena Djeric, zëvendës kryesues dhe Filloreta Bytyçi, Ilir Dugolli, Adil Pireva, Sandra Basic-Hrvatini, Katrin Nyman-Metcalf, anëtarë të Këshillit.

Mandati i anëtarëve vendorë është përcaktuar në takimin e parë të Këshillit kur është bërë tërheqja me short. Me këtë rast është përcaktuar mandati fillestar për një vjet për z. Berisha dhe z. Dugolli përderisa anëtarët tjerë vendorë kanë mandatin dy vjeçar. Anëtarët ndërkombëtare kanë mandate fillestare prej 18, respektivisht 12 muaj të përcaktuar nga PSSP-ja.

**Në takimin e parë,** Këshilli i diskutoi politikat kryesore në mënyrë që të themelojë rregullat dhe procedurat e brendshme, kodin etik për Këshillin e KPM-së dhe stafin si dhe një politikë për hartimin transparent dhe publik të rregullave në pajtim me kërkesat e Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim (Ligji i KPM-së). Po në këtë takim janë shqyrtuar edhe buxheti dhe draft politikat për të rregulluar subjektet transmetuese.

Këshilli ka miratuar në parim Buxhetin për vitin 2007 dhe përcaktimet për të ruajtur atë buxhet nga ndikimet qeveritare siç kërkohet me standardet evropiane dhe Ligjin e KPM-së, përderisa për draft politikat ka vendosur që të bëhen publike për subjektet transmetuese dhe palët e tjera të interesuara për të ofruar komentet dhe shqetësimet e tyre para miratimit të tyre.

**Në takimin e dytë,** të mbajtur më 18 dhe 19 shtator 2006, Këshilli shqyrtoi draft politikat për rregullimin e subjekteve transmetuese dhe komentet nga mediat dhe publiku. Këshilli i miratoi Politika e Transmetimit dhe Udhëzimet e KPM-së për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve, përderisa draft politika për Koncentrimin e Mediave, Vendimin për Nivelin dhe Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Taksës për Licencë të Radio dhe TV vendosi që t'i dërgojë për komente publike.

**Në takimin e tretë,** të datës 16 tetor 2006, Këshilli i KPM-së, pas konkursit të hapur për zgjedhjen e Shefit Ekzekutiv të KPM, në mes të një numri kandidatësh përzgjedhi dhe emëroi znj. Naile Selimaj – Krasniqi për Shef Ekzekutiv të Zyrës së KPM-së. Pas kësaj, Këshilli ka shqyrtuar dhe ka vendosur për dy raste të hapura të Divizionit të Licencimit.

Më 30 nëntor 2006 Këshilli i KPM-së ka mbajtur **takimin e katërt** dhe të fundit për vitin 2006. Pas komenteve të pranura nga publiku dhe subjektet transmetuese, Këshilli shqyrtoi sërish draft Vendimin për nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës të taksës për licencim për radio dhe TV të cilin e ndryshoi dhe vendosi që ta dërgojë sërish për komente. Në po këtë takim, nga Këshilli është vlerësuar dhe analizuar në përgjithësi situata e mediave në Kosovë dhe në fokus të analizës ishin mediat dhe komunitetet. U konkludua që komuniteti rom nuk ka radio apo televizion në gjuhën e vet dhe se është e nevojshme që në këtë aspekt të ndërmirret diçka. Këshilli vendosi që të bëjë një përjashtim duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara nga komuniteti rom të konkurojnë për radio përmes një tenderi publik i cili do të hapet në fillim të vitit 2007, pasi që të jenë përcaktuar kriteret për konkurrim. Licenca e re që do t'i ndahet kandidatit më të suksesshëm në konkurrim do të jetë e vlefshme vetëm deri në kohën e ri-licencimit, ku të gjitha subjektet transmetuese do t'i nënshtrohen procesit të konkurimit për një frekuencë për radio apo televizion për një regjion të caktuar.

## REALIZIMI I DETYRAVE TË KËSHILLIT NË BAZË TË LIGJIT

Që nga konstituimi i tij, në gusht 2006 deri në fund të vitit 2006 Këshilli i KPM-së, gjatë katër mbledhjeve të mbajtura në këtë vit ka miratuar një sërë aktesh nënligjore - rregullore të cilat përcaktojnë punën e KPM-së dhe krijojnë bazën për lëshimin e çfarëdo vendimi..

Rregulloret e miratuara nga Këshilli janë:

1. **Rregullat e Procedurës të Këshillit të KPM-së**, me të cilën përcaktohen rregullat e funksionimit të Këshillit të KPM-së.
2. **Kodi Etik për KPM-së**, i cili përcakton standardet më të larta të mirësjelljes së stafit të KPM-së, duke përfshirë integritetin, paanshmërinë dhe objektivitetin.
3. **Politika e Këshillit të KPM-së në hartimin publik të rregullave**. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të siguroj transparencë, paanësi dhe drejtësi të procesit për krijimin e rregullave për mediat në Kosovë.
4. **Politika e Transmetimit**, e cila përcakton parimet kryesore të transmetimit, siç janë: Standardet Etike, Dialogu Ndëretnik dhe Shërbimet për Komunitetet Minoritare, Mbrojtja e të Miturve dhe Konsumatorëve, Promovimi i Qasjes Publike në Informata, Sigurimi i Konkurrencës së Drejtë.
5. **Udhëzimet e KPM-së për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve**, qëllimi i të cilave është të definohet politikat e KPM-së në vënien e sanksioneve për shkelje të Rregulloreve të KPM-së, pas konfirmimit të këtyre shkeljeve në përputhje me rregullat e procedurës së KPM-së.

Të gjitha këto akte nënligjore kanë hyrë në fuqi më 28 gusht 2006.

Përveç këtyre, Këshilli ka filluar të punojë në përgatitjet për procesin e ri-licencimit në mënyrë që të përmbushë edhe një obligim tjetër të përcaktuar me Ligjin e KPM-së. Një numër rregullash, rregulloresh, politikash dhe planesh duhet të miratohen para fillimit të procesit. Për këtë qëllim, Këshilli ka krijuar disa grupe punuese të përbashkëta me personelin e Zyrës së Shefit Ekzekutiv, të cilët do të punojnë bashkarisht për të themeluar bazën për:

- Procesin e licencimit;
- Rregullimin e operatorëve kabllorë;
- Politikat e reklamimit;
- Mbrojtjen e të miturve;
- Koncentrimin e Mediave;
- Planin frekuencor të transmetimit analog; dhe
- Planin frekuencor dixhital.

Për shkak të natyrës së këtyre lëmive që janë të reja në Kosovë dhe të cilat kërkojnë një analizë të thellë të praktikave më të mira në vendet tjera, dhe si mund të adaptohen dhe aplikohen ato në kontekstin e Kosovës, grupet punuese do t'ia paraqesin publikut dhe mediave draftet e para për t'u mundësuar pjesëmarrjen e tyre me komente vetëm në 2007.

Draft vendimi për nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës për licencim për radio dhe TV i cili ishte i shpallur në uebfaqen e KPM-së për komente nga transmetuesit dhe palët e interesuara pritet të miratohet herët në 2007.



Rregulloret si dhe dokumentet tjera të miratuara nga Komisioneri i Përkohshëm për Media vazhdojnë të mbesin në fuqi deri në amendamentimin, zëvendësimin ose shfuqizimin e tyre nga Këshilli i KPM-së.

## **ZYRA E SHEFIT EKZEKUTIV**

Është organi i dytë i Komisionit të Pavarur për Media që duhet të zbatojë të gjitha aspektet e politikës së transmetimit; përgatit propozimin për buxhetin dhe rekomandon Këshillin përkitazi me çështjet e politikës dhe çështjet lidhur me buxhetin dhe administratën.

### **Departamenti i Rregullimit të Transmetimit**

Departamenti i Rregullimit të Transmetimit mbikëqyr aktivitetet e përgjithshme të KPM-së duke koordinuar punët e divizionit Ligjor, Licencimit, Monitorimit/Pajtueshmërisë dhe Menaxhimit Frekuencor. Ofron mbështetje dhe këshilla për Shefin Ekzekutiv për të gjitha qështjet që kanë të bëjnë me licencimin, zbatimet dhe zhvillimet e politikave rregullative të KPM-së. Mbikëqyr zhvillimet e politikave dhe procedurave rregullative të transmetimit dhe koordinon zhvillimet profesionale të personelit brenda Departamentit Rregullativ.

### **Divizioni i Licencimit**

Divizioni i Licencimit udhëheq konkursin e licencimit për licenca e reja të transmetimi dhe punon ngushtë me subjektet transmetuese ekzistuese në çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me kushtet e licencave të tyre. Divizioni i Licencimit bashkëpunon me Divizionin Teknik, Ligjor dhe Monitorues të KPM-së për të zgjidhur problemet e interferencave në mes subjekteve transmetuese dhe në rishqyrtimin e kërkesave prej subjekteve transmetuese për të ndryshuar licencat e tyre.

### **Divizioni Ligjor**

Divizioni Ligjor këshillon KPM-në në të gjitha çështjet ligjore që kanë të bëjnë me licencimin, ankesat prej publikut dhe përgatitjen e rregullave dhe udhëzimeve të reja për subjektet transmetuese. Divizioni Ligjor përgatit rastet sanksionuese dhe këshillon KPM-në në të gjitha seancat ligjore. Divizioni Ligjor gjithashtu shërben si këshillë i përgjithshëm i KPM-së, në këshillimet administrative si dhe në çështjet rregullative.

### **Divizioni i Monitorimit**

Divizioni i Monitorimit dhe Pajtueshmërisë monitoron mediat elektronike dhe periodikisht viziton subjektet transmetuese për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së dhe për të ndihmuar KPM-në që më mirë të kuptoj problemet dhe shqetësimet e subjekteve transmetuese. Monitoruesit e KPM-së pranojnë ankesa prej publikut dhe i shqyrtojnë ato në konsultim me Divizionin Ligjor, Teknik dhe të Licencimit në mënyrë që të këshillojnë Shefin Ekzekutiv për çfarëdo veprimi rregullativ që mund të kërkohej. Divizioni i Monitorimit gjithashtu mund të inicioj ankesë të vet ex-officio.

### **Divizioni i Menaxhimit të Frekuencave (DMF)**

Divizioni i Menaxhimit Frekuencor cakton parametrat e transmetimit për secilin subjekt transmetues, përfshirë frekuencat, fuqinë e sinjalit dhe lokacionin e antenës. Duke përdorur programe planifikuese të sofistikuar të frekuencave, Divizioni i Menaxhimit Frekuencor harton hapësirën e mbulimit të secilit subjekt transmetues në një hartë shumë të saktë topografike të

Kosovës për të siguruar që secili radio stacion apo televizion mund të mbulojë hapësirën e vet të licencuar pa i penguar subjektet tjera transmetuese. Ky Divizion po ashtu kryen veprime monitoruese në terren për të verifikuar pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me kushtet teknike të licencave të tyre.

## **Departamenti i Administratës**

Departamenti i Administratës është përgjegjës për të gjitha çështjet financiare, të personelit, logjistikës dhe prokurimit në KPM, përfshirë menaxhimin e buxhetit të saj (që rrjedh prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës)

## **AKTIVITETET E ZYRËS SË SHEFIT EKZEKUTIV**

Zyra e Shefit Ekzekutiv është përgjegjëse për çështje operative ditore, të cilat lidhen më për së afërmi me çështje të rregullimit të subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM. Kjo nënkupton procedimin e rasteve, ankesave, kërkesave të paraqitura në KPM nga subjektet transmetuese dhe nga publiku, si edhe rastet e iniciuara nga vetë KPM. Secili rast shqyrtohet sipas procedurave të caktuara nga Divizioni përkatës apo në bashkëpunim.

### **Rastet e procesuara nga Divizioni Ligjor**

#### *Rastet për transmetim pa licencë-transmetim ilegal*

Gjatë vitit 2006, për transmetim pa licencë janë proceduar katër raste (Ankesat me numra 2006/01;2006/10; 2006/11;2006/23). Të katër transmetuesit ilegal e kanë pranuar Njoftimin për Shkelje të ligjit të KPM-së nenit 11.1 i cili thotë:

*“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni”.*

Pas pranimit të Njoftimi për Shkelje të ligjit të KPM-së, të katër transmetuesit i kanë ndërprerë transmetimet pa licencë dhe pajtueshmëria e tyre më ligjin e KPM-së është duke u monitoruar.

Gjatë sanksionimit për shkelje të rregulloreve të saja, KPM-ja synon, kur do që të jetë e realizueshme, që të inkurajojë veprime përmirësuese, marrëveshje dhe profesionalizëm më të lartë nga të licencuarit.

KPM-ja ka politikat e veta për zbatimin e sanksioneve ndaj subjekteve transmetuese për shkeljen e Rregulloreve të KPM-së pas konfirmimit të këtyre shkeljeve në përputhje me rregullat e procedurës së KPM-së. KPM-ja në bazë të këtyre politikave parasheh natyrën progresive të sanksioneve ku përveq shkeljeve të rënda të Rregulloreve, sanksionet në përgjithësi do të ndjekin një shkallë progresive, duke filluar me një Vërejtje për shkeljen e parë të një Rregulloreje të KPM-së. Një apo më shumë dënime në përgjithësi do t'i paraprijnë çfarëdo suspendimi të licencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një vendim paraprak të KPM-së apo përsëritja e shkeljeve të njëjta do të rezultojë në dënime më të ashpra. Gjithashtu sanksionet do të jene proporcionale me natyrën dhe më seriozitetin e një shkelje dhe më shkallën ekonomike të të licencuarit, duke marr parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.

*Rastet për transmetimin e programeve komerciale pa të drejtën autoriale, dështimit të sjelljes së arkivit dhe ndërprerjes së transmetimit*

Sa i përket rasteve ku është shkelur e drejta autoriale, dështimi i sjelljes së arkivës dhe ndërprerjes së transmetimit nga subjektet transmetuese janë proceduar katër raste:

Ankesa numër 2006/02, - mosrespektim i të së drejtës së autorit, KPM ka lëshuar vendim më të cilin i është tërhequr vërejtja më shkrim subjektit transmetues. Rasti është mbyllur

Ankesa numër 2006/04, – për mosrespektim të të drejtës së autorit KPM ka zgjedhur rastin me marrëveshje të përbashkët\* me subjektin transmetues. Marrëveshja është monitoruar nga ana e KPM-së, subjekti transmetuese i është përmbajtur marrëveshjes. Rasti është mbyllur.

Ankesa numër 2006/06 – mosrespektim i të drejtës së autorit nga ana e subjektit transmetues, dështim për t'i ofruar KPM-së arkivën e kërkuar dhe ndërprerje të transmetimit pa e njoftuar KPM-në, ashtu siç kërkohet në Pjesën e Parë të Licencës. KPM ka lëshuar vendim me të cilin i është tërhequr vërejtja me shkrim subjektit transmetues për shkeljet e bëra. Rasti është mbyllur.

Ankesa numër 2006/18 - për mosrespektim të të drejtës së autorit, gjatë periudhës kur KPM dhe subjekti transmetues kishin marrëveshje të përbashkët po ashtu për mosrespektim të së drejtës së autorit, Këshilli i KPM-së ka lëshuar vendim me të cilin i caktoi gjobën prej 500 Euro dhe ka obliguar subjektin transmetues që t'i transmetojë publikisht detajet e natyrës dhe shkallës së shkeljes. Subjekti transmetues ka paguar gjobën dhe rasti është mbyllur.

#### *Rastet për interferenca*

Divizioni ligjor i KPM-së ka proceduar vetëm një rast Ankesën më numër 2006/09 ku subjekt transmetuese i ka shkaktuar ka shkaktuar interferencë një subjekti tjetër transmetues, dhe pasi që KPM-ja i ka dërguar Njoftim për Shkelje të rregulloreve të KPM-së, subjekti transmetues ka evituar interferencat dhe ka riparuar transmetuesin dhe antenën si është kërkuar nga KPM-ja. Rasti është mbyllur.

#### *Rastet për mos transmetim për më shumë se 90 ditë, kusht i paraparë me licencë:*

Divizioni ligjore ka proceduar Ankesën më numër 2006/08 për mos transmetim për me shumë se 90 ditë siç është e parapare me licence për të rifilluar transmetimin. Në pamundësi që të vazhdojë veprimtarinë e vet transmetuese, subjekti transmetues ka hequr dorë vullnetarisht nga licenca e KPM-së dhe KPM-ja ka lëshuar vendim me të cilin ia revokon licencën për transmetim subjektit transmetues.

#### *Rastet e paraqitura nga palët ndaj lajmeve të RTK-së:*

Në divizionin ligjor janë proceduar dy raste (Ankesat më numër 2006/14; 2006/15) pas parashtrimit të ankesave nga publiku ndaj lajmeve qendrore dhe atyre Blic të RTK-së.

---

\* Sqarim: Nëse KPM-ja konkludon që një rregullore, apo kushtet dhe termet e licencës janë shkelur ajo së pari do të përpiqet të gjej një zgjidhje apo marrëveshje jashtë-gjyqësore që kënaq të dyja palët, mediumin dhe personin apo organizatën që ka parashtruar ankesën pa ushtruar sanksione formale. Zgjidhjet e mundshme përfshijnë: Një sqarim apo korrigjim nga mediumi; e Drejta për Kundërpërgjigje dhënë për qytetarin që ankohet; Kërkim Faljeje publike prej mediumit; marrëveshje e përbashkët me sanksion suspendues. Një marrëveshje me një të licencuar është e përshtatshme kur i licencuari në bazë të vullnetit të tij pranon shkeljen dhe demonstroi një gatishmëri të besueshme për të ndërmarrë veprime përmirësuese si: trajnim të personelit, riorganizim apo nxjerrja e rregullave të brendshme të përcaktuara të parandalojnë kryerjen e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen).

Komisioneri i Përkohshëm për Media ka refuzuar të dy ankesat në mungesë të fakteve. Rastet janë mbyllur

*Rastet për transmetim jo të rregullt:*

Ankesa më numër 2006/16 subjekti transmetues nuk ka transmetuar ashtu siç është obliguar sipas licencës dhe nuk ka përmbushur obligimet për të transmetuar program i cili i shërben publikut. Për këtë Këshilli i KPM-se lëshoi vendim me të cilin i tërhiqet vërejtja dhe urdhërohet që të filloj t'i përmbush obligimet që i ka në bazë të vendimit licencues deri me 1 tetor 2006. Nëse subjekti transmetues dështon në përmbushjen e këtyre obligimeve atëherë do t'i revokohet licenca. Rasti është duke u proceduar nga ana e KPM-së

*Rastet për mos përgjigje ndaj kërkesave të KPM-së dhe mos pajtueshmëri me kushtet e licencës*

Ankesa më numër 2006/17, Këshilli i KPM-së i lëshoi vendim me të cilin e sanksionoi më gjorbë prej 500 euro subjektin transmetues si dhe e obligoi që t'i transmetojë publikisht shkeljet e bëra subjektin transmetues. Subjekti transmetues nuk është ankuar para Bordit të Mediave për Ankesa brenda afatit prej 30 ditëve të parapara për ankesë sipas ligjit të KPM-së dhe deri me tani nuk e ka paguar gjorbën e vënë nga KPM-ja. Rasti është duke u proceduar nga ana e KPM-së

*Rastet për transmetim nga vendi i pa licencuar*

Ankesa më numër 2006/24, subjekti transmetues ka ndërruar vendin e transmetuesit pa lejen e KPM-së. Sipas licencës subjekti transmetues nuk mund ta ndërroj vendin e transmetuesit pa pëlqimin paraprak me shkrim të KPM-së. Rasti është duke u proceduar nga ana e KPM-së.

*Rastet e paraqitura para Bordit të Mediave për Ankesa*

Ligji për KPM-në parasheh se Vendimet sanksionuese të Këshillit të KPM-së mund të apeloohen brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të vendimit.

Gjatë 2006 janë të paraqitura pesë raste para Bordit të Mediave për Ankesa (BMA).

Ankesa me numër 2006/03 Subjekti transmetues ka paraqitë ankesë kundër Vendimit Licencues të KPM-së me të cilin i është refuzuar kërkesa për zgjerim të fushës së mbulimit. Bordi i Mediave për Ankesa kthen rastin për rishqyrtim tek KPM-ja. Këshilli i KPM-së lëshoi vendim me të cilin i mohon kërkesën për zgjerimin e fushës së transmetimit subjektit transmetues për shkak të pamundësisë që kjo të realizohet në pajtueshmëri me planin frekuencor për Kosovën.

Ankesa më numër 2006/05 është paraqitur dy herë para BMA. Së pari ka marrë vendimin nga BMA me të cilin është ndryshuar vendimi i KPM-së dhe gjoba e përcaktuar më parë nga KPM-ja prej 4000 euro është zbritë në 1000 euro. Subjekti transmetues ka paguar gjorbën dhe rasti është mbyllur.

Ankesa më numër 2006/07, BMA i ka mbajtur dy seanca. Seanca e parë ishte shtyrë për të marrë mendimin e ekspertëve i cili do t'i paraqitej BMA-së deri në fund të shtatorit 2006. Ekspertë të jashtëm të angazhuar nga KPM dhe subjekti transmetues kanë vlerësuar se është e mundur të realizohen kushtet dhe termat teknike të caktuara me licencën e subjektit transmetues, të cilin e ka kontestuar subjekti transmetues. BMA ka vendosur që nëse për shkak të kushteve atmosferike subjekti transmetues nuk mund t'i kthejë antenat sipas

parametrave teknike të përcaktuar me licencë të përcaktuar me licencë brenda afatit prej 30 ditëve atëherë ky afat shtyhet deri me 1 maj 2007. Nëse subjekt transmetues nuk e respekton këtë vendim atëherë pas kësaj date do t'i revokohet licenca në mënyrë automatike.

Ankesa më numër 2006/12, subjekti transmetues ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Komisionerit të Përkohshëm për Media për mos vazhdim të licencës. Ky subjekt transmetues kishte licencë të përkohshme prej gjashtë muajve më kusht që licenca do t'i vazhdohej nëse i mbush kushtet e caktuar në licencë për program në shërbim të publikut. Subjekti transmetues nuk i përmbushi obligimet e dala nga licenca dhe për këtë arsye nuk i është vazhduar licenca. BMA e refuzoi Ankesë Apelimin si të pa bazë dhe mbështeti vendimin e KPM-së.

Ankesa më numër 2006/13 aplikuesi për licence është paraqitur para BMA-së me ankesën kundër Vendimit të Komisionerit të Përkohshëm për Media për mos dhënien e licencës. BMA refuzoi Ankesë Apelimin si të pa bazuar dhe mbështeti vendimin e KPM-së.

Ankesa më numër 2006/13a, aplikuesi për licence ka paraqitur ankesën kundër Vendimit të Komisionerit të Përkohshëm për Media, me të cilin nuk i është dhënë licenca për arsye se nuk i ka përmbushur kriteret e caktuara. BMA ktheu rastin për rishqyrtim tek KPM-ja duke u bazuar në informatat e reja që aplikuesi për licence nuk i kishte ofruar më parë KPM-së. Këshilli i KPM-së lëshoi vendimin me të cilin subjektit transmetues i lëshohet licencë e vlefshme vetëm deri në procesin e ri-licencimit.

Sipas ligjit për KPM-në vendimet e BMA janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim më ligjin në fuqi.

#### *Rastet e papërfunduara:*

Në fund të vitit 2006, te Bordi i Mediave për Ankesa janë parashtruar tri ankesa (2006/19; 2006/20;2006/22) ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së të cilat mbesin të procedohen në fillim të vitit 2007.

### **Rastet e procesuara nga Divizioni i Licencimit**

Licenca transmetuese është kontratë formale në mes të autoritetit rregullativ dhe një radio apo televizioni, e cila i lejon subjektit transmetues shfrytëzimin e një pjese të spektrit të frekuencave. Subjektet transmetuese veprojnë në pajtueshmëri me licencën e përkohshme të modifikuar në vitin 2005, e cila përbëhet nga Memorandumi Shpjegues, Çertifikata, Kushtet dhe termet e përgjithshme, Kushtet dhe termet teknike, Programi dhe Zona e mbulimit e licencës e paraqitur në hartë.

Kushtet dhe termet e licencës janë përcaktuar për t'u siguruar që secili subjekt transmetues t'i shërbej interesit të gjerë publik me qëllim të një rregullimi të transmetimit profesional dhe të paanshëm. Në bashkëpunim me Divizionin e Monitorimit, Divizionin Ligjor dhe Divizionin e Menaxhimit Frekuencor, Divizioni i Licencimit ka ofruar udhëzime dhe sugjerime për subjektet transmetuese sipas nevojës.


Në Kosovë aktualisht operojnë 116 subjekte transmetuese të licencuara nga KPM. KPM licencon subjektet transmetuese sipas zonës së mbulimit në tre kategori:

- Subjekte transmetuese me mbulim mbarë-kosovar
- Subjektet transmetuese me mbulim lokal dhe

- Subjektet transmetuese me fuqi të ulët transmetimi

Ndarja e subjekteve transmetuese të licencuara në Kosovë sipas kategorive të mbulimit duket si më poshtë:


- 3 televizione me mbulim mbarë-kosovar (1 televizion publik, 2 televizione private)
- 4 radiostacione me mbulim mbarë-kosovar (2 radio publike, 2 radio private)
- 17 televizione me mbulim lokal
- 74 radiostacione me mbulim lokal
- 2 televizione me fuqi të ulët transmetimi
- 16 radiostacione me fuqi të ulët transmetimi



**Tabela 1. Paraqitja e mediave elektronike sipas kategorisë**

Sipas gjuhës kryesore në të cilën transmetojnë:

- 73 subjekte transmetuese transmetojnë në gjuhën shqipe si gjuhë kryesore (62%). Këtu përfshihet edhe subjekti transmetues publik
- 35 subjekte transmetuese transmetojnë në gjuhën serbe si gjuhë kryesore (30%)
- 3 subjekte transmetuese në gjuhën boshnjake (3%)
- 3 subjekte transmetuese në gjuhën turke (3%), dhe
- 2 subjekte transmetuese në gjuhën gorane (2%)




**Tabela 2. Paraqitja e mediave elektronike sipas gjuhës kryesore**


Sipas ndarjes regjionale, shpërndarja e mediave është:

- në Gjilan, 34 subjekte transmetuese;
- në Mitrovicë, 21 subjekte transmetuese;
- në Pejë, 14 subjekte transmetuese;
- në Prishtinë, 28 subjekte transmetuese; dhe
- në Prizren, 19 subjekte transmetuese.


Tabelat në vijim pasqyrojnë shpërndarjen e subjekteve transmetuese në secilin regjion, sipas llojit (radio dhe TV) dhe gjuhës në të cilën transmetojnë.




**Tabela 3. Regjioni i Gjilanit**




**Tabela 4. Regjioni i Mitrovicës**



**Tabela 5. Regjioni i Pejës**



**Tabela 6. Regjioni i Prishtinës**



**Tabela 7. Regjioni i Prizrenit**



Radio Televizioni i Kosovës (RTK) pos transmetimit në gjuhën shqipe transmeton edhe në katër gjuhë të tjera: serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome.

Një e treta e subjekteve transmetuese janë stacione në gjuhën serbe dhe afër 30 % e të gjitha subjekteve transmetuese ofrojnë program në së paku dy gjuhë që fliten në Kosovë. Prandaj një prej qëllimeve të KPM-së është që në Kosovë të ketë një shumëllojshmëri të mediave për secilin komunitet, duke i ofruar atyre qasje në informim në gjuhën e tyre përkatëse.

Kur subjektet transmetuese të licencuara në Kosovë janë në kundërshtim me kushtet e licencës së tyre, rregullat, rregulloret apo aktet tjera juridike që janë në pajtueshmëri me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, atëherë KPM-ja ka autoritetin që të ndërmarrë një numër masash disiplinore duke filluar prej vërejtjeve formale deri tek sanksionet financiare. Në raste të jashtëzakonshme, KPM-ja mund të suspendojë apo të anulojë licencat transmetuese. Poashtu, kur subjekteve transmetuese u paraqiten probleme për shkaqe të ndryshme, KPM, respektivisht Divizioni i Licencimit në bashkëpunim me Divizionet tjera, subjekteve transmetuese të licencuara në Kosovë ju ofron edhe asistencë për t'u mundësuar atyre të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me standardet profesionale.

Gjatë vitit 2006 Divizioni i Licencimit ka pranuar kërkesa dhe ankesa të ndryshme nga bartësit e licencave. Gjithashtu, janë iniciuar edhe raste *ex-officio* kur është vërejtur shkelje e kushteve dhe termeve të licencës nga ana e subjekteve transmetuese. Në Divizionin e Licencimit janë paraqitur gjithsej 39 raste të natyrave të ndryshme si: kërkesa për ndryshim të sistemit të transmetimit; ankesa për ndërhyrje; zgjerim të zonës së mbulimit; shkelje të kushteve dhe termeve të licencës; transmetim ilegal dhe revokim të licencës.

#### *Kërkesa për ndryshim të lokacionit të sistemit të transmetuesit:*

Për arsye teknike, dhe të tjera, 7 subjekte transmetuese kanë kërkuar të ndryshojnë lokacionin e sistemit të transmetimit. Për t'i asistuar subjektet transmetuese në mbarëvajtjen e punës së tyre, KPM, respektivisht Divizioni për Menaxhim të Frekuencave, ka bërë vlerësimet teknike për të bërë zgjidhjen adekuate. Ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit nënkupton ndryshim në zonën e mbulimit me sinjal të subjektit transmetues, andaj këto vlerësime janë të domosdoshme për t'u siguruar që subjekti transmetues do të vazhdojë veprimtarinë e vet pa shkaktuar ndërhyrje tek subjektet tjera të licencuara në Kosovë. Këto raste janë përfunduar pas aprovimeve me shkrim nga KPM, pasi që ndryshimet në fjalë nuk kanë rezultuar në ndryshime të parametrave teknike të përcaktuara sipas licencës së subjekteve transmetuese.

#### *Ankesa për ndërhyrje:*

Në KPM janë parashtruar 8 ankesa nga subjekteve transmetuese lidhur me ndërhyrje në frekuenca/kanale të tyre. Të gjitha subjektet transmetuese që kanë parashtruar ankesa në KPM për ndërhyrje në sinjalet e tyre transmetuese, pas vlerësimeve teknike që janë bërë nga DMF, kanë marrë përgjigje me shkrim nga Divizioni i Licencimit me sqarime specifike lidhur me shkaktimin e ndërhyrjes si dhe janë udhëzuar për zgjidhjen e natyrës së problemit të tyre. Përveç një rasti i cili është paraqitur në fund të vitit 2006 dhe që është ende në proces, 7 ankesat tjera konsiderohen raste të mbyllura nga ana e Divizionit të Licencimit.

### *Kërkesë për zgjerim të zonës së mbulimit:*

Në KPM janë paraqitur 5 raste me kërkesë për ndryshim/zgjerim të zonës së mbulimit. KPM ju është përgjigjur këtyre kërkesave me sqarimin se Këshilli i KPM-së ka marrë qëndrim që kërkesat e tilla të shqyrtohen gjatë procesit të ri-licencimi.

### *Shkelje të kushteve dhe termeve të licencës:*

Gjatë vitit 2006 KPM ka vërejtur shkelje të kushteve dhe termeve të licencës nga 4 subjektet transmetuese. Ato shkelje kanë të bëjnë me ndërprerje të stërzgjatura të transmetimit, ndryshim të lokacionit të sistemit të transmetimit pa miratim të KPM-së si dhe shkelje të së drejtës së autorit. Prandaj, të gjitha këto raste kanë kaluar tek Divizioni Ligjor.

### *Transmetim ilegal*

Në bazë të Ligjit të KPM dhe Transmetim asnjë subjekt transmetues nuk ka të drejtë transmetimi pa u pajisur me licencë të KPM-së. Në vitin 2006 janë paraqitur 4 raste të transmetimit ilegal të cilat janë proceduar më tutje nga Divizioni Ligjor.

### *Revokim i Licencës*

Gjatë vitit 2006 KPM ka revokuar 2 licenca për transmetim. Rasti i parë ka ndodhur kur një subjekt transmetues i licencuar të transmetoje në regjionin e Gjilanit, në pamundësi të vazhdojë veprimtarinë ka hequr dorë vullnetarisht nga licenca e KPM-së. Ndërsa, rasti i dytë ka të bëjë me një subjekt transmetues i licencuar përkohësisht në regjionin e Prizrenit të cilit, për mos respektim të kushteve dhe termeve të licencës së përkohshme, KPM nuk i ka vazhduar licencën. Rasti ka kaluar të gjitha procedurat e KPM-së dhe pas mbështetjes së vendimit të KPM-së nga Bordi i Mediave për Ankesa licenca e këtij subjekti transmetues është revokuar.

Në proces për shqyrtim nga KPM mbeten 9 raste të cilat do të barten për t'u përfunduar në vitin 2007.

## **Rastet e procesuara nga Divizioni i Menaxhimit të Frekuencave (DMF)**

DMF ka realizuar një numër të konsiderueshëm të monitorimeve teknike në gjithë territorin e Kosovës (me përjashtim të veriut të Kosovës). Nga studimi i të dhënave të grumbulluara është konstatuar se problemet kryesore teknike ishin ndërhyrjet e stacioneve tek njëri-tjetri si rezultat i cilësisë së dobët të aparaturave transmetuese.

Gjithsejt, DMF ka proceduar 24 raste teknike gjatë vitit 2006:

- 8 ankesa për interferenca
- 7 kërkesa për ndryshim të lokacionit
- 5 kërkesa për zgjerim të zonës së mbulimit me sinjal
- 4 kërkesa për ndryshime të kanaleve

Për të gjitha këto raste DMF ka bërë:

- matje teknike në terren, respektivisht lokacionet prej nga kanë ardhur kërkesat;
- ka përpiluar raportet me vlerësimet për gjetjet në terren

- u ka bërë rekomandime subjekteve transmetuese si edhe Divizionit të Licencimit për zgjidhjen më të mirë të mundshme për subjektet transmetuese, dhe
- ka vizituar dhe ka asistuar subjektet transmetuese në zgjidhjen e problemeve teknike të sistemeve transmetuese

DMF vepron në pajtueshmëri me planin frekuencor analog të Kosovës, të përcaktuar me standarde të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (UNT). Aktualisht, në territorin e Kosovës, në shfrytëzim janë 208 kanale frekuencore ku 52 janë TV kanale dhe 156 janë FM kanale

Frekuencat janë të ndara për pesë lloj shërbimesh:

- 37 kanale frekuencore përdoren për mbulim nacional (18 TV kanale, 16 FM dhe 3 lokale)
- 53 kanale frekuencore përdoren nga KFOR-i (11 TV kanale dhe 42 FM kanale)
- 92 kanale frekuencore lokale (17 TV kanale dhe 75 FM kanale)
- 22 kanale frekuencore me fuqi të vogël (6 TV kanale dhe 16 FM kanale)
- 4 kanale frekuencore ndërkombëtare në FM (BBC, RFI ,DJ,VoA).

### **Çështja e dixhitalizimit**

Ligji i KPM-së autorizon KPM-në që të bëjë edhe rregullimin e transmetimit dixhital. Në vitin 2006, nga 15 maj deri më 16 qershor, në Gjenevë është mbajtur Konferenca Rajonale e Radiokomunikacioneve (RRC-06) Gjeneva 2006 për përkufizimin e Platformës Dixhitale dhe për koordinimin e transmetimit dixhital në breza VHF/UHF përmes rregullatorëve të rajoneve përkatëse.

Në unionin Evropian, vitet e fundit është shfaqur një trend i ri i tranzicionit teknologjik duke kaluar nga transmetimi analog radiodifuziv në atë dixhital - (DVB-T). Sistemet (DVB-T) ofrojnë mundësi shumë më të mëdha në krahasim me sistemin e tanishëm televiziv analog. Njëra nga përparësitë bazë është shfrytëzimi më efikas i brezit radiodifuziv sepse me një kanal frekuencor mund të transmetohen 4 deri në 8 programe televizive. Gjithashtu këto sisteme mundësojnë zgjerimin e zonave të tanishme të shërbimit, gjegjësisht që nën kushte të caktuara pranim të sinjalit edhe në zonat ku nuk ka pamje optike dhe gjithashtu mundësohet hyrja në HDTV. DVB-T sistemet mundësojnë edhe lloje të ndryshme të pranimit të sinjalit si: fiks, portabel dhe mobil.

Iniciativën kryesore si dhe kohëzgjatjen e këtij tranzicioni (kalimi nga sistemi i transmetimit analog në atë dixhital) po e bëjnë organizatat ndërkombëtare që merren me rregullimin e transmetimit dhe aspektet tjera rreth transmetimit. Në këtë rast organizata më e madhe ndërkombëtare për rregullimin e transmetimit Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (UNT) ka caktuar një afat ku në mënyrë graduale përfshin të gjitha vendet duke ju caktuar edhe kohëzgjatjen (afatin) e kalimit nga sistemi i transmetimit analog në atë dixhital.

Sa i përket këtij organizimi për planifikim dixhital Kosova, gjegjësisht KPM si rregullator i vetëm i transmetimit në Kosovë, nuk është ftuar në asnjë grup punues që është bërë nën organizimin e UNT-së, si dhe nuk është përfshirë në punimet që janë organizuar ndërmjet rregullatorëve të rajonit për organizimin dhe harmonizimin e planit frekuencor dixhital. Këro përgatitje kanë zgjatur për mëse dy vite dhe Kosova gjatë kësaj kohe nuk ka pasur kontakte koordinimi zyrtar me asnjë nga vendet e rajonit sa i përket kësaj çështje. Përkundër përpjekjeve për t'u inkuadruar në këtë proces, UNT nuk e ka përfshirë Kosovën me arsyetimin se për shkak të statusit të padefinuar të Kosovës, ajo përfaqësohet nga Serbia dhe Mali i Zi.

Akti final i cili është aprovuar dhe nënshkruar nga 120 vendet pjesëmarrëse dhe vëzhguese në këtë Konferencë do të jetë bazë për zhvillim të mëtutjeshëm dhe implementimin e shërbimeve Dixhitale radiodifuzive tokësore. KPM nuk posedon informata zyrtare se çka është vendosur me këtë akt për zhvillimin dhe implementimin e planit dixhital për Kosovën.

## **Projektet e Divizionit të Monitorimit**

Divizioni i Monitorimit i KPM-së deri tani kryesisht ka vepruar në bazë të ankesave të parashtruara nga ana e publikut si dhe rastet e iniciuara nga vet Zyra (*ex officio*). Në rast të ankesave nga ana e publikut Divizioni i Monitorimit i KPM-së ka bërë monitorimin dhe analizimin e përmbajtjes së programit të caktuar. Gjetjet dhe analizat e këtij Divizioni ishin baza mbi të cilat Divizioni Ligjor i mbështette veprimet e ndërmarra ligjore.

Gjatë viti 2006 Divizioni i Monitorimit i KPM-së gjithashtu ka realizuar edhe dy projekte të monitorimit të programe të stacioneve televizive. Projekti i parë i monitorimit u realizua gjatë Kampionatit Botërorë në Futboll – Gjermania 2006 dhe kishte për qëllim verifikimin i respektimit të të Drejtës së Autorit, të përcaktuar me Kushtet dhe Termet e Licencës për Transmetim të lëshuar nga KPM.

Projekti i dytë i monitorimit u realizua në tetor të këtij viti dhe kishte për qëllim analizën e përgjithshme të programeve të televizioneve kosovare. Me këtë rast të gjitha stacioneve televizive ju është kërkuar arkivi dy ditor i programeve të tyre të cilat janë analizuar për paanshmërinë e raportimit, gjuhën e urrejtjes si dhe respektimin e të drejtës së autorit.

Me qëllim që të përfitohet nga praktikat më të mira të njërive të Monitorimit të agjencioneve rregullative në regjion dhe të propozohet një model i monitorimit i cili do të jetë më i përshtatshëm për Divizionin e Monitorimit, dy nga monitoruesit e këtij Divizioni u dërguan për të kryer një hulumtim në njësitë e Monitorimit të katër Agjencive Rregullative të Transmetimit në regjion. Hulumtimi është kryer nga 16 deri më 27 nëntor 2006. Monitoruesit e KPM-së kanë vizituar Agjencitë e Rregullimit të Transmetimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni dhe kishte për interes:

- Qëllimet dhe objektivat e Monitorimit
- Kapacitetet njerëzore (Personeli, Arsimimi, Trajnimi)
- Financat (investimet fillestare, shpenzimet operationale)
- Infrastruktura teknike (hard]are, soft]are, ruajtja dhe analiza e të dhënave)
- Perspektivat e monitorimit (IPTV, Internet-radio, dixhitalizmi)

## **ZBATIMI I LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTE ZYRTARE**

KPM ka ueb faqen e saj në të cilën pasqyrohet puna dhe aktivitetet e KPM-së në kuadër të mandatit të saj.

Kjo ueb faqe, gjithashtu, pasqyron angazhimin e KPM-së për transparencë duke dhënë informacion të plotë për rregulloret e veta, për proceset e marrjes së vendimeve dhe komentet për legjislacionin që ka të bëjë me mediat elektronike, përshkrimet e tenderëve dhe të vendeve të punës në KPM.

Në ueb faqen e KPM-së janë të postuara Ligji për KPM-në, aktet nënligjore, kushtet dhe termet e licencës si dhe të gjitha vendimet e Këshillit të KPM-së.

Gjithashtu në seksionin Vendimet të ueb faqes së Zyrës së KPM-së postohen të gjitha vendimet lidhur me ankesat nga subjektet transmetuese dhe publiku; vendimet për licencim si dhe ato të Bordit të Mediave për Ankesa.

Këtu mund të merren informata rreth subjekteve transmetuese, përfshirë lokacionin, ndarjen e tyre sipas regjioneve, detajet kontaktuese, stafin menaxhues si dhe gjuhët në të cilat transmetojnë ato.

Ueb faqja e KPM-së ofron mundësinë e lidhjes me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të cilat poashtu kanë në fokus rregullimin e mediave. Duke ndjekur praktikat më të mira evropiane, KPM-ja harton projekt rregulloret dhe direktivat e veta të cilat janë të hapura për komente para miratimit të verzioneve përfundimtare.

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT TJERA**

KPM ka kontribuar në zhvillimin e legjislacionit që ka të bëjë me mediat përmes pjesëmarrjes në grupet punuese dhe paraqitjes së komenteve dhe sugjerimeve. Më konkretisht, KPM ishte pjesëmarrëse në grupet punuese për hartimin e Ligjit të Radio Televizionit të Kosovës, Ligjit për të Drejtën e Autori dhe draft Ligjit për Shpifje dhe Fyerje.

Komisioni i Pavarur për Media ka ndihmuar **Zyrën e Kryeministrit** në hartimin e Politikës së Inkurajimit dhe Mbrojtjes së Mediave, që janë në Shërbim të Komuniteteve Minoritare dhe të Pafavorizuara në Kosovë. Poashtu, ka marrë pjesë në komisionin këshilldhënës për ndarjen e granteve për media minoritare dhe multietnike dhe të Grupeve tjera të Pafavorizuara, komision ky i formuar me vendim të Qeverisë së Kosovës dhe i kryesuar nga Zyra e Kryeministrit.

KPM ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me rregullatorët e tjerë të mediave të Evropës jug-lindore. Vetëm gjatë vitit 2006 janë zhvilluar disa vizita në zyrat e rregullimit të transmetimit në rajon, duke përfshirë Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Bosnjën e Hercegovinën me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e rregullimit të mediave elektronike.

Fillimisht, KPM-ja i ka konkretizuar zotimet e saja ndaj standardeve evropiane të mediave duke iu bashkuar **Platformës Evropiane të Agjencive Rregullative (EPRA)**, një shoqatë profesionale e përbërë nga 49 agjenci rregullative përgjatë Evropës. Që nga anëtarësimi i KPM-së në EPRA (në vitin 2003 si anëtare e 49 me të drejta të barabarta) zyrtarët e saj kanë qenë pjesëmarrës në të gjitha takimet dhe konferencat që kjo shoqatë ka organizuar. Në vitin 2006 janë mbajtur dy takime, njëri në Elsinore të Danimarkës më 17-19 maj 2006 dhe tjetri më 4-6 tetor 2006 në Dubrovnik të Kroacisë, në të cilat është diskutuar për çështje me interes për agjencionet rregullative, respektivisht edhe për Komisionin e Pavarur për Media i cili ka përfituar nga shkëmbimi i përvojave dhe ekspertizës së kolegëve nga agjencionet anëtare të kësaj platforme, sidomos gjatë procesit të tranzicionit.

Një vend të rëndësishëm në fushën e bashkëpunimit që KPM ka me organizatat tjera e zë edhe **OSBE-ja**, ku përveq ndihmës së këshilldhënies përmes një këshilltari për KPM-në, OSBE-ja ka ndihmuar KPM-në edhe në aspektin financiar. Disa nga udhëtimet zyrtare si pjesëmarrja në konferencat e EPRA-s, takimi në Këshillin e Evropës, vizitat që janë bërë në zyrat rregullative të rajonit dhe disa nga shpenzimet e Këshillit të KPM-së dhe BMA-së janë mbuluar nga kjo organizatë.

Një delegacion i Zyrës së Komisionierit të Përkohshëm për Media, me 16-17 maj 2006 mori pjesë në Konferencën “E ardhmja e politikës audiovizuale dhe bashkëpunimi regjional në Ballkanin Perëndimor” e organizuar në Bruksel nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Këshillin Evropian. Qëllimi i gjithmbarshëm i kësaj konference ishte që të vazhdohet shkëmbimi i

përvojave në mes të organizatave ndërkombëtare, autoriteteve rregullative, përfaqësuese të qeverive të vendeve të Ballkanit perëndimor si dhe të sektorit privat, së bashku me identifikimin e nevojave vendore dhe mundësive konkrete të ndihmës ndërkombëtare dhe të Komisionit Evropian për reformën e vazhdueshme ligjore dhe zbatimin e saj.

Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës është i një rëndësie shumë të veçantë për KPM-në. Ky bashkëpunim kryesisht është i përqëndruar në aspektin këshilldhënës dhe ndihmë gjatë përpilimit të rregulloreve të cilat KPM-ja i zbaton në raport me mediat elektronik.

KPM-ja rregullisht konsultohet me organizatat e lartëpërmendura për të siguruar se ajo ndjek standardet e duhura evropiane, të cilat janë definuar nga **Këshilli i Evropës** dhe është mbështetur nga **Komisioni Evropian**.

## PASQYRA E BUXHETIT TË KPM-së PËR VITIN 2006

Planifikimi i Buxhetit i vitit 2006 ka filluar me buxhetin e aprovuar në shumën prej 360,369.00 Euro. Prej buxhetit të aprovuar me rishikimin e gjysmë-vitit në bazë të Udhëzimit Administrativ 2006/14 KPM ka pasur një ndryshim të ndarjeve buxhetore në kategorinë e pagave. Është zbritur shuma prej 10,807.00 për shkak të mjeteve të lira prej gjysmëvitit në mungesë të mosplotësimit të numrit të të punësuarve.

Shuma e pashpenzuar nga ndarjet buxhetore është suficiti prej 11. 692.46 Euro që dmth se KPM ka realizuar një planifikim të buxhetit për 96% të shfrytëzimit të buxhetit.


Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Komisioni i Pavarur për Media ka marrë fondin e OSBE-së në shumë prej 20,000.00 euro për të realizuar fushatën për senzibilizimin e publikut për Komisionin e Pavarur për Media.

Nga fondi i alokuar nga donatori në shumën prej 20,000.00 janë shpenzuar vetëm 17,874.12 Euro. Alokimi i pashpenzuar është bartur në vitin 2007 në shumë prej 2,125.88, për t'ju kthyer pastaj donatorit në pajtueshmëri me marrëveshjen paraprake për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

	<b>Buxheti i Aprovuar</b>	<b>Alokimet Buxhetore</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Buxheti i Pashpenzuar</b>	<b>Alokimi i Pashpenzuar</b>
Kompenzimi i të Punësuarve	79,269.00	68,462.00	63,569.10	4,892.90	4,892.90
Mallrat dhe shërbimet	261,100.00	261,100.00	256,881.15	4,218.85	4,218.85
Shpenzimet Komunale	20,000.00	20,000.00	17,419.29	2,580.71	2,580.71
<b>Totali</b>	<b>360,369.00</b>	<b>349,562.00</b>	<b>337,869.54</b>	<b>11,692.46</b>	<b>11,692.46</b>
Fondi i Donatorëve		20,000.00	17,874.12	2,125.88	2,125.88
<b>Totali</b>		<b>20,000.00</b>	<b>17,874.12</b>	<b>2,125.88</b>	<b>2,125.88</b>


Nr.	Emërtimi	Alokimet Fondi i Përgjithshëm		Fondi i Donatorëve	Totali (3+4+5)
		Të Hyrat vetanake	Llogaria e Thesarit granti i Qeverisë		
1	2	3	4	5	6
1.	Të Hyrat(1a deri 1c)				369,562.00
a	Granti i Qeverisë		349,562.00		349,562.00
b	Të Hyrat vetanake				
c	Grantet e përcaktuara			20,000.00	20,000.00
2.	Shpenzimet(a deri c)		337,869.54	17,874.12	355,743.66
a	Kompensimet e të Punësuarve		63,569.10		63,569.10
b	Mallra dhe Shërbime		256,881.15	17,874.12	274,755.27
c	Shpenzimet Komunale		17,419.29		17,419.29
3.	Gjendja e të Hyrave të Pashpenzuara(nr.1-nr.2)		-11,692.46		-11,692.46
4.	Granti i Qeverisë i Pashpenzuar(-nr.3kol.4)		11,692.46	2,125.88	13,818.34
<b>5.</b>	<b>Totali(nr.3+-4)</b>		<b>0</b>	<b>2,125.88</b>	<b>2,125.88</b>

## SKEMAT ORGANIZATIVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA



---

### KËSHILLI I KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA





# BORDI I MEDIAVE PËR ANKESA


ORGANIZIMI

Prof. Dr. Wolfgang Benedek – Kryetar

Anton Nokaj / Anëtar i Bordit

Avdi Dinaj / Anëtar i Bordit

# ZYRA E SHEFIT EKZEKUTIV





KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

CIMC- 2006/5  
28 gusht 2006

## **Komisioni i Pavarur për Media Politika e Transmetimit**

### **Preambula:**

Bazuar në Nenin 3.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin, Këshilli i Komisionin të Pavarur të Mediave (KPM) në pajtueshmëri me parimet e lirisë së shprehjes dhe praktikën më të mira evropiane themelon në vijim Politikën e Transmetimit. Kjo Politikë do të përcaktojë punën e KPM-së dhe do të krijojë bazat për lëshimin e çfarëdo vendimi dhe rregullore. Politika do të krijojë gjithashtu bazat për funksionimin e subjekteve transmetuese në Kosovë.

### **Neni 1. Standardet Ndërkombëtare të Transmetimit**

Kjo Politikë e Transmetimit ndjek standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të drejtave të njeriut, duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Përveç kësaj, politika e transmetimit do të jetë në pajtim të plotë me legjislacionin përkatës të Kosovës. Politika do të interpretohet ashtu që të sigurojë zbatimin e saj dhe të shtojë parimet e lirisë së shprehjes në pajtueshmëri me garancitë e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Rregullimi i transmetimit do të bazohet në parimet e objektivitetit, proporcionalitetit – që do të thotë se çfarëdo intervenimi rregullativ nuk është më shumë se ajo çka nevojitet për t'u arritur objektivi i synuar i politikës së transmetimit, dhe transparencës.

### **Neni 2. Standardet Etike Përgjithësisht të Pranuar**

Të gjitha transmetimet do të përmbushin standardet etike përgjithësisht të pranuar të kualitetit, balancës, objektivitetit dhe pluralizmit. E drejta për reagim duhet të respektohet nga ana e subjekteve transmetuese. Do të krijohen kushte të favorshme për zhvillimin e një game të llojllojshme të subjekteve transmetuese publike dhe private. Duhet kuptuar rëndësia e transmetimit me qëllim të promovimit të vlerave demokratike.

### **Neni 3. Dialogu Ndëretnik dhe Shërbimet për Komunitetet Minoritare**

KPM-ja do të inkurajojë veçmas transmetimin i cili promovon diversitetin kultural e gjuhësorë, inkurajon dialogun ndër-etnik, shpërndarjen gjeografike më të gjerë të mundshme duke përfshirë edhe inkurajimin e televizioneve regjionale në çdo regjion dhe t'u shërbejë komuniteteve të Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme. KPM-ja duhet të parandalojë çfarëdo shfrytëzimi të transmetimit për nxitje të urrejtjes ose përhapjes së paragjyqimeve. Programet më përmbajtje religjioze mund të transmetohen vetëm nëse dëshmohet se nuk portretizojnë një religjion si më superior ndaj tjetrit dhe nuk denigrohet ndonjë religjion, nuk ftojnë për anëtarësim në ndonjë organizatë religjioze dhe nuk përmban mesazhe me propagandë politike.

KPM-ja do të inkurajojë çdo qytet, fshat ose popullatë tjetër e koncentruar minoritare më e madhe se 500 persona të ketë qasje së paku në një program 30 minutësh në ditë në radio apo televizion

privat në gjuhën e atij komuniteti, duke paraparë që aplikuesit për licencë të ofrojnë këso shërbimesh, plotësojnë kualifikimet për licencë.

#### **Neni 4. Mbrojtja e të Miturve dhe Konsumatorëve**

Programet e transmetuara duhet të inkurajojnë mbrojtjen e të miturve dhe të konsumatorëve. Programet edukative cilësore do të inkurajohen. Politika e transmetimit do të marr parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe grupeve tjera me nevoja të veçanta që të kenë qasje në transmetim.

#### **Neni 5. Promovimi i Qasjes Publike në Informata**

Transmetimi duhet të kontribuoj në sigurimin e qasjes në informim sipas praktikave më të mira Evropiane dhe legjislacionit relevant të Kosovës.

#### **Neni 6. Sigurimi i Konkurrencës së Drejtë**

Sektori i transmetimit do të jetë pluralist dhe i bazuar në konkurrencë të drejtë. Licenca për transmetim nuk do t'i lëshohet ndonjë etniteti ose organizate qeveritare. Monopolizimi i transmetuesve duhet të parandalohet. Parimet ndërkombëtare dhe ligjet relevante të Kosovës për të drejtën e pronës intelektuale do të aplikohen.

#### **Neni 7. Qëndrueshmëria Ekonomike e Subjekteve Transmetuese**

Realizueshmëria financiare dhe kualiteti teknik i transmetimit si dhe përdorimi i teknologjisë së re do të inkurajohet. Rregullimi kurdo që është e mundur duhet të jetë teknologjikisht neutral. Rregullimi i transmetimit nga ana e KPM-së duhet të krijojë një politikë dhe ambient të qartë dhe të parashikueshëm, ku subjektet transmetuese mund të planifikojnë investimet dhe zhvillojnë strategjitë.

#### **Neni 8. Qasja Publike në Ngjarjet Madhore përmes Transmetimit**

Mundësitë e qasjes më të gjere të shikuesit dhe dëgjuesit në ngjarjet me rëndësi madhore për shoqërinë do të sigurohen. Këshilli i KPM-së do të përcaktoj se cilat ngjarje janë të një rëndësie të tillë që ato të jenë të arritshme për të gjithë në pajtueshmëri më ligjin dhe parimet Evropiane, përfshirë Lojërat Olimpikë; kampionatet botërore dhe evropiane në futboll, hendboll, dhe sporte tjera të cilat janë tradicionale në Kosovë; garat ndërkombëtare të cilat zhvillohen në Kosovë ose me pjesëmarrjen e ekipit të Kosovës, gara të rëndësishme muzikore dhe ngjarje tjera me interes të veçantë për audiencën kombëtare.

#### **Neni 9. Promovimi i Produksionit Lokal dhe Evropian**

Politika e Transmetimit do të këtë qëllim promovimin e produksioneve lokale dhe Evropiane të veprave audiovizuale si dhe të produksioneve të pavarura. KPM-ja duhet të sigurojë se subjektet transmetuese do të përfshijnë një pjesë të këtyre veprave në programet e tyre në pajtueshmëri me rregullat specifike të theksuara në kushtet e licencës dhe varësisht nga lloji i licencës së transmetimit.

#### **Neni 10. Implementimi i Televizionit pa Kufij**

Parimet e Konventës dhe Direktivës së Televizionit pa Kufij që synon në koordinimin e rregullave nacionale dhe heqjen e barrierave në mes shteteve në Evropë, duke bërë transmetimin lehtë të pranishëm pavarësisht nga kufijtë nacional duhet të aplikohet kur kjo të jetë e mundur.

#### **Neni 11. Hyrja në Fuqi**

Kjo Politikë do të aplikohet që nga 29 gusht 2006.

[Adaptuar më 28 gusht 2006]



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

CIMC- 2006/4  
28 gusht 2006

## **Udhëzimet e KPM-së në Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve**

---

**1.0 Qëllimi:** Qëllimi i këtyre udhëzimeve është të definoj politikat e KPM-së në vënien e sanksioneve për shkelje të Rregulloreve të KPM-së, pas konfirmimit të këtyre shkeljeve në përputhje me rregullat e procedurës së KPM-së.

### **2.0 Përkufizimet:**

**2.1 Rregullore:** “Rregullore” do të thotë kushtet dhe konditat e përgjithshme dhe specifike të licencës së Komisionerit të Përkohshëm për Media/Komisioni i Pavarur për Media; kodet të zbatueshme ndaj përmbajtjes së transmetuar; Kualifikimet për Licencë të KPM-së; urdhrat e vlefshëm apo udhëzimet që Këshilli i KPM-së mund t’i aprovoj lidhur me veprimet apo sjelljet e të një licencuari; dhe të gjitha deklaratat tjera të të drejtave dhe obligimeve të subjekteve transmetuese në Kosovë të lëshuara nga KPM-ja apo PSSP-ja si dhe ato të shpallura nga Komisioneri i Përkohshëm për Media që mbesin në fuqi.

**2.2 I Licencuar:** I Licencuar do të thotë një subjekt transmetues i radios apo televizionit të cilit Komisioneri i Përkohshëm për Media apo agjencioni pasardhëse i saj, KPM, i jep një licencë dhe përdorimin e frekuencës(ave) përcjellëse për transmetim. [Ngjashëm si në Pjesën e I-rë të Licencë]

**2.3 Sanksione:** Dënime financiare apo dënime tjera të lejuara për shkelje të rregulloreve të KPM-së sipas Ligjit për KPM-në dhe Transmetime.

### **3.0 Politikat e Përgjithshme:**

**3.1 Natyra progresive e sanksioneve:** Përveç për shkelje të rënda të Rregulloreve, sanksionet në përgjithësi do të ndjekin një shkallë progresive, duke filluar me një Vërejtje për shkeljen e parë të një Rregullore të caktuar. Një apo më shumë dënime në përgjithësi do t’i paraprijnë çfarëdo suspendimi të licencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një vendim paraprak të KPM-së apo përsëritja e shkeljeve të njëjta do të rezultojë në dënime më të ashpra, duke përfshirë dënime më të mëdha në rritje për shkelje të rregullores së njëjtë apo të barasvlershme të KPM-së.

**3.2 Natyra proporcionale e sanksioneve:** Sanksionet do të jene proporcionale me natyrën dhe më seriozitetin e një shkelje dhe më shkallën ekonomike të të licencuarit,

dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.

**3.3 Preferencë për veprime përmirësuese:** Gjatë ndëshkimit të shkeljeve të rregulloreve të saja, KPM-ja do të synojë, kur do që të jetë e realizueshme, që të inkurajojë veprime përmirësuese, marrëveshje dhe profesionalizëm më të lartë nga të licencuarit.

**4.0 Marrëveshjet:** Një marrëveshje me një të licencuar është e përshtatshme kur i licencuari në bazë të vullnetit të tij pranon shkeljen dhe demonstroi një gatishmëri të besueshme për të ndërmarrë veprime përmirësuese si: trajnim të personelit, riorganizim apo nxjerrja e rregullave të brendshme të përcaktuara të parandalojnë kryerjen e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.

**4.1 Pranimi i shkeljeve:** Marrëveshjet kërkojnë një pranim të shprehur qartë të shkeljes nga ana e të licencuarit.

**4.2 Gjobat e suspenduara:** Një Marrëveshje mund të përshijë një dispozitë për pagim të një gjobe. Obligimi për të paguar nja gjobë mund të suspendohet për një kohë të kufizuar para se obligimi përfundon, në përgjithësi gjashtë muaj, në mungesë të shkeljeve shtesë të rregulloreve të KPM-së. Kryerja e shkeljeve të njëjta gjatë kohës kur është vendosur gjoba por është suspenduar me një Marrëveshje shkakton një obligim për të paguar dënimin e vendosur. Një Vendim i Këshillit mund të vë një dënim shtesë për shkeljen pasuese.

**4.3 Veprimi përmirësues:** Një Marrëveshje duhet të përcaktoj veprimin përmirësues të cilin i licencuari duhet ta ndërmerr.

**4.4 Të dhënat disiplinore:** Një rast i zgjidhur nëpërmjet një Marrëveshje me të cilën subjekti transmetues vepron në pajtueshmëri brenda afatit të Marrëveshjes nuk përbën një shkelje dhe nuk duhet që në përgjithësi të konsiderohet si pjesë e të dhënave disiplinore të të licencuarit. Mirëpo, KPM-ja mund të merr parasysh faktet themelore të rastit të zgjidhur në vendimet rregullative në të ardhmen.

**5.0 Konfiskimi i një pajisje:** KPM-ja mund të urdhëroj konfiskimin e një pajisje vetëm për qëllim të dhënies fund të transmetimit të pa-licencuar. Një konfiskim i tillë do të jetë opsioni i fundit, nëse urdhrat e shkruara çartë për operuesin e një transmetuesi të pa-licencuar për të ndërprerë dhe larguar pajisjen e pa-licencuar dëshmojnë të jenë jo-efektive.

**5.1** Konfiskimi do të jetë i kufizuar në minimumin e pajisjeve të domosdoshme për të arritur ndaljen e transmetimit ilegal. KPM-ja do t'i jep pronarit apo operuesit të një pajisje të tillë një Urdhër të vlefshëm për Konfiskim dhe një vërtetim për pajisjen, nëse identiteti i pronarit/operuesit mund të përcaktohet.

**5.2** Pajisja e konfiskuar do të mbahet nga KPM-ja në një vend të sigurt, për t'iu rikthyer pronarit të saj të ligjshëm në momentin e garancive të kënaqshme se transmetimi ilegal nuk do të rishfaqet. KPM-ja mund të vendosë për një pajisje të tillë në përputhje me ligjin relevant.

**6.0 Suspendimi i Licencës:** KPM-ja do të suspendoj një licencë vetëm kur do të kryhen shkelje të rënda, të përsëritura apo të pandërprera të Rregulloreve. Çfarëdo veprimi i tillë do të jetë në përputhje me një qasje proporcionale dhe progresive ndaj sanksioneve.

**6.1 Rrethanat për Suspendim të Licencës:** Suspendimi i licencës mund të justifikohet me njëren nga rrethanat e më poshtme:

- 6.1.1** Vënia e mëhershme e gjobave të konsiderueshme (më shumë se dy) për shkelje të rregulloreve të KPM-së.
- 6.1.2** Mos pagesa e një gjobe në fuqi e KPM-së; kohëzgjatja e suspendimit do të jetë proporcionale me shkallën e gjobës së pa paguar.
- 6.1.3** Suspendimi i një kohëzgjatje të kufizuar dhe proporcionale në vend të vënies së ndonjë gjobe, nëse ka mjaft arsye për të besuar se i licencuari nuk do të jetë në gjendje që të paguaj gjobën.
- 6.1.4** Shkelje jashtëzakonisht serioze e Rregulloreve të KPM-së të cilat paraqesin kërcënim të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik.

## **6.2 Procedurat për suspendim të licencës:**

- 6.2.1** Në të gjitha rastet, KPM-ja do të ofroj vërejtje me shkrim të qartë se suspendimi mund të urdhërohet. Vërejtja duhet të ofroj justifikime të qarta dhe të detajuara, të citoj rregullore të zbatueshme të KPM-së dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për subjektin transmetues për t'u përgjigjur dhe për të korrigjuar shkeljen në fjalë.
- 6.2.2** Këshilli i KPM-së do t'i ofroj të licencuarit një mundësi për një seancë dëgjimore para paraqitjes së Vendimit për Suspendim, përveç nëse Këshilli përcakton se serioziteti i shkeljeve është i tillë që vazhdimi i transmetimit paraqet një kërcënim të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik.
- 6.2.3** Në rrethana të një kërcënimi të çartë dhe të menjëhershëm për rendin publik, sipas këshillës së Shefit Ekzekutiv të KPM-së, Kryesuesi i Këshillit të KPM-së, në momentin e sigurimit të një miratimi të të paktën të tre anëtarëve tjerë të Këshillit, mund të lëshoj një Urdhër Emergjent për Suspendim të vlefshëm deri atëherë kur Kryesuesi i Këshillit përcakton se i licencuari nuk do të paraqes kërcënim për rendin publik. Ky veprim duhet të miratohet nga i tërë Këshilli sa më shpejtë që të jetë e mundshme.

**7.0 Revokimi i Licencës:** Revokimi i licencës mund të justifikohet me njëren nga rrethanat si në vijim:

**7.1 Përfundim Vullnetar i transmetimit me njoftim të KPM-së:** Një i Licencuar që vullnetarisht përfundon operimet e tij dhe njofton për këtë KPM-në do të konsiderohet se vullnetarisht e ka dorëzuar licencën e tij. Me të marrë një njoftim të tillë KPM-ja do ta konsideroj licencën të jetë e pavlefshme dhe të anuluar. Personeli i KPM-së do ta këshilloj Këshillin, i cili do ta lëshoj një Urdhër për Revokim të licencës pa paragykuar në ndonjë aplikacion të ardhshëm për licencë të cilin i licencuari mund ta paraqes.

**7.2 Ndërprerja e Transmetimit pa Njoftuar KPM-në:** KPM-ja mund ta revokoj licencën nëse përcakton se i licencuari i kishte ndërprerë, e jo thjeshtë suspenduar, operimet e tij pa dërguar njoftim për ndërprerje të KPM-ja. Ndërprerja është definuar si njëra prej pikave në vijim përveç ndaljes së transmetimit: (a) ndërprerje e marrëdhënies së punës të gjithë

personelit për të operuar më stacionin ku i njëjti personel është punësuar më herët; (b) anulim i regjistrimit të biznesit; (c) heqja e premisave dhe/apo pajisjeve për transmetim.

**7.3 Dështimi për të përdorur Licencën:** Dështimi nga i Licencuari apo Aplikuesi për të shfrytëzuar plotësisht apo në vazhdimësi licencën e dhënë më herët nga KPM-ja mund të merret si një dëshmi për mos aftësi për të menaxhuar dhe mbajtur një operim profesional të transmetimit, dhe mund të rezultojë në anulim të licencës. Një dështim i tillë mund të definohet si dështimi për të filluar me transmetim brenda kohës të përcaktuar në licencë, dështimi i vazhdueshëm për të transmetuar minimumin e orëve të kërkuar në licencë apo ndërprerja e stërzgjatur apo e madhe e transmetimit, përveç nëse pengesat e tilla vijnë si rezultat i *force majeure*.

**7.3.1 Ndërprerjet e stërzgjatura:** Gjashtëdhjetë (60) ditë në vazhdimësi të ndërprerjes së transmetimit për arsye tjera nga *force majeure*, apo 90 ditë jo në vazhdimësi brenda një periudhe gjashtë mujore, e kombinuar me dështimin për të paraqitur një plan të besueshëm për KPM-në për vazhdim të transmetimit definohet si ndërprerje e stërzgjatur. Një ndërprerje e tillë do të merret për të treguar paaftësinë e mundshme të të licencuarit për të operuar më një stacion transmetimi me standardet minimale të profesionalizmit. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të anulohet për Dështim për ta Shfrytëzuar, dhe do të lejoj të paktën 14 ditë për të licencuarin për t'u përgjigjur me një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

**7.3.2 Transmetim i çrregullt e i stërzgjatur:** Pengesat madhore të përsëritura në, apo ndryshimet e mëdha të, kohës ditore të transmetuar që nuk kanë të bëjnë me *force majeure*, gjatë një kohe prej 60 ditë apo më shumë. Ndërprerje të tilla do të merren për të treguar paaftësinë e mundshme të të licencuarit për të operuar më një stacion transmetimi me standardet minimale të profesionalizmit. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të revokohet për Transmetim të Çrregullt dhe të stërzgjatur, dhe do të lejoj të paktën 14 ditë për të licencuarin për t'u përgjigjur me një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

**7.3.3 Dështimi në vazhdimësi për të shfrytëzuar minimalisht licencën:** Dështimi për të shfrytëzuar minimalisht një frekuencë të licencuar për transmetim siç është përcaktuar në licencën e KPM-së për një periudhë prej 60 ditë apo më shumë, apo 90 ditë në një periudhë gjashtë mujore, për arsye jo të lidhura me shkaktarë të jashtëm do të jetë një bazë për revokim të licencës. KPM-ja do ta njoftoj të licencuarin se licenca e tij mund të revokohet për mos aftësi të shfrytëzimit të frekuencës, dhe do t'i lejoj të paktën 14 ditë të licencuarit për t'u përgjigjur me një plan të besueshëm për vazhdim të transmetimit dhe të dëshmoj arsyen se pse licenca nuk duhet revokuar.

**7.3.4 Suspendimi i dytë i licencës:** Shkeljet e përsëritura apo të vazhdueshme të rregulloreve të KPM-së të cilat do ta justifikonin suspendimin e dytë brenda periudhës dy vjeçare mund të shërbejnë si baza për revokim të licencës.

**7.3.5 Shkelje jashtëzakonisht e madhe e Rregulloreve të KPMs-së:** (1) dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një urdhër për suspendim; (2) kryerja e një shkelje rregullative e cila qartë inkurajon apo rezulton në një akt të çrregullimit të rendit publik do të konsiderohen si baza për revokim të licencës.

- 7.3.6 Dështimi për t'i përmbushur Kualifikimet e KPM-së për Licencë:** një i licencuar i cili në mënyrë të pavërtetë dhe mashtruese pohon pajtueshmëri me Kualifikimet e KPM-së për Licencë mund ta ketë licencën e tij të revokuar me tu dëshmuar një pavërtetësi apo mashtrim i tillë. Një i licencuar të cilit statusi apo rrethanat i ndryshojnë ashtu që ta bijën të licencuarin jo në përputhje me Kualifikimet e KPM-së për Licencë mund ta ketë licencën e tij të revokuar nëse dështon, gjatë një kohe të arsyeshme, për t'i korrigjuar rrethanat diskualifikuese. Para revokimit të licencës në rrethana të tilla, KPM-ja do t'i ofroj të licencuarit të paktën 60 ditë për të kërkuar miratimin e KPM-së për shitje apo transferim tjetër të licencës tek një i licencuar i kualifikuar apo përndryshe të korrigjoj diskualifikimin.
- 7.3.7 Shitja e paaautorizuar e një subjekti transmetues:** Licenca mund t'i revokohet nëse një subjekt transmetues është shitur apo transferuar tek një palë e tretë në shkelje të kushteve të licencës.
- 7.3.8 Nevoja e Interesit Publik në Konkurs:** Në rrethana të veçanta, KPM-ja mund të përcaktoj se shitja apo transferimi i nja subjekti transmetues tek një i licencuar i propozuar nuk është në interes të publikut. Në raste të tilla, KPM-ja mund të hapë një konkurs publik për frekuencën(at) relevante në të cilin blerësi i propozuar apo pranuesi i transferit mund të konkurroj pa paragjykime. Më tu dhënë konkursi, licenca origjinale do të revokohet.

**8.0 Procedurat për revokim të licencës:** Në të gjitha rastet, KPM-ja do të ofroj vërejtje shpjeguese të qartë se revokimi mund të urdhërohet, dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për të licencuarin për t'u përgjigjur dhe për të korrigjuar çështjet në fjalë.

**8.1** Në të gjitha rastet e propozuar për revokim të licencës, KPM-ja do të ofroj vërejtje me shkrim të qartë se revokimi mund të urdhërohet. Vërejtja duhet të ofroj justifikime të qarta dhe të detajuara, të citoj rregullore të zbatueshme të KPM-së dhe do të ofroj një kohë të arsyeshme për subjektin transmetues për t'u përgjigjur.

**8.2** Këshilli i KPM-së do t'i ofroj të licencuarit një mundësi për një seancë dëgjimore para dhënies së Vendimit për Revokim.

#



**Komisioneri i Përkohshëm për Media  
Prishtinë, Kosovë**

8 shtator 2000

**KODI I SJELLJES  
PËR MEDIUMET ELEKTRONIKE  
NË KOSOVË**

Derisa, Seksioni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 mbi Dhënjën e Lejeve (Licencimin) dhe Rregullimin e Mediemeve Elektronike në Kosovë ia jep Komisionerit të Përkohshëm për Medieme përgjegjësini për zbatimin e regjimit të përkohshëm rregullativ për të gjitha mediat në Kosovë;

Derisa, nën-Seksioni 2.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 thotë se Komisioneri i Përkohshëm për Medieme duhet të nxjerr Kodin e Sjelljes për Mediumet Elektronike;  
Duke afirmuar respektimin e parimeve të Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut që përmban këto norma:

Neni 19

*“Secili gëzon të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit pa interferenca dhe lirinë për të kërkuar, për të pranuar dhe për të kumtuar informata dhe ide nëpërmjet të gjitha mediave dhe pa marrë parasyshë kufijtë”.*

dhe

Neni 29

*“Secili ka obligime ndaj shoqërisë që i bënë të mundshëm zhvillim të lirë dhe të plotë të personalitetit;  
“Në ushtrimin e të drejtave dhe të lirive të veta, secili do t’u nënshetrohet vetëm atyre kufizimeve të përcaktuara me ligj vetëm për qëllime të sigurimit të njohjes dhe të respektit të të drejtave dhe të lirive të tjerëve dhe që janë në pajtim me normat morale, rendin publik dhe mirëqenien e përgjithshme në një shoqëri demokratike”.*

Duke affirmuar respektimin e parimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të pesë protokoleve të saj që përmbajnë këto norma:

Neni 2

*“1. E drejta e secilit për jetë duhet të mbrohet me ligj...”*  
dhe

Neni 5

*“Secili gëzon të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale...”*

dhe në rastet e shqyrtimeve para gjyqeve të themeluara me ligj

## Neni 6

“1 ... shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i tërë apo nga një pjesë e procesit gjyqsorë në interes të moralit, të rendit publik ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e adoleshentëve apo mbrojtja e privatësisë të palëve e kërkojnë atë, ose në qoftë se, sipas një qëndrimi nga gjyqi një gjë e tillë është e domosdoshme në rrethana të posaqme ku publikimi do të shkonte në dëm të interesave të drejtësisë”.

“2. Secili që është i ngarkuar për vepër penale duhet të konsiderohet si i pafajshëm deri sa fajësia të vërtetohet në gjyq”.

dhe

## Neni 10

“1. Secili e gëzon të drejtën e lirisë së shprehjes ...”

“2. Pasi ushtrimi i këtyre lirive përmbanë edhe obligime dhe përgjegjësi, liritë mund t’u nënshtrohen atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo ndëshkimeve që janë të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurisë kombëtarë, të integritetit teritorial dhe të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave dhe të krimit, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e prestigjit dhe të drejtave të tjerëve, për parandaimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanësisë të drejtësisë”.

Në pajtim me nën-Seksionin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/36, nxjerret ky Kod i Sjelljes për Mediumet Elektronike:

### Seksioni 1 Konkurimi

*Të gjithë pronarët, drejtuesit e stacioneve, kryeredaktorët dhe/ose ata që bëjnë redakturën përfundimtare të të gjitha programeve radio apo televizive në Kosovë (tani e tutje u referohet vetëm me “emetues”) pajtohen t’i përmbahen këtij Kodi si kusht për marrjen e lejes të transmetimit nga Komisioneri i Përkohshëm për Mediume.*

### Seksioni 2 Deklaratat Provokative

I tërë programi do të jetë në pajtim me standardet përgjithsisht të pranuar të civilizimit ndërkombëtarë dhe të respektojë llojllojshmërinë etnike, kulturore dhe fetare të Kosovës. Emetuesit nuk do të transmetojnë asnjë material që nxitë krim ose aktivitete kriminale, ose që përmbanë në vehte rrezikun e shkaktimit të dëmit, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo ndonjë formë tjetër e dhunës. Emetuesit nuk do të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik ose fetar, ose që nënkupton se një grup etnik apo fetar është përgjegjës për aktivitete kriminale.

### Seksioni 3 Privatësia

Emetuesit nuk do të transmetojnë asnjë material që me qëllim ose vetvetiu i mveshë ndonjë individ përgjegjës penale para se të shpallet fajtor nga gjyqi i konstituuar me ligj.

Emetuesit nuk do të japin emrat, përshkrimin, fotografinë, ngjashmërinë ose informatat specifike të ndonjë individi që gjoja ka kryer një krim, derisa organet e autorizuar të qeverisjes të drejtësisë nuk japin shprehimisht autorizim se një informatë e tillë mund të bëhet publike, ose derisa individi në fjalë nuk është shpallur fajtor për kryerjen e krimit nga gjyqi i themeluar me ligj.

#### Seksioni 4 Drejtësia dhe Paanshmëria

Emetuesit do të përpiqen të sigurojnë korrektësi, drejtësi dhe paanshmëri në të gjitha raportimet. Emetuesit do të përpiqen të prezantojnë këndvështrimet e ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë.

Emetuesit nuk do t'i favorizojnë interesat e një partie politike ose të një pikëpamje politike, as nuk do të jenë pjesëmarrës të një praktike që mund të ketë efekt të promovimit të një partie politike, një këndvështrimi politik, ndonjë grupi ose individi, që i përjashtojnë partitë tjera, pikëpamjet tjera, grupet tjera ose individët tjerë.

#### Seksioni 5 Ligji i Zbatueshëm

Emetuesit duhet t'i respektojnë ligjet në Kosovë që zbatohen në aktivitetet e medimeve, duke përfshirë, por jo edhe duke u kufizuar në rregullat elektorale.

#### Seksioni 6 Dallimi ndërmjet Lajmeve dhe Opinionit

Derisa janë të lirë t'i shprehin mendimet e veta, emetuesit do të bëjnë çmos për të bërë dallim të qartë ndërmjet komentit, supozimit dhe fakteve, dhe poashtu qartazi do t'i përcaktojnë editorialet dhe komentet si të tilla.

#### Seksioni 7 Materiali i Pavërtetë dhe Mashtrues

Emetuesit nuk do të transmetojnë material për të cilin dinë ose duhet ta dinë se është i pavërtetë apo mashtrues.

Emetuesit nuk do të transmetojnë material derisa nuk e bëjnë kërkimin rutinor dhe të arsyeshëm për të siguruar saktësinë e tij.

#### Seksioni 8 Gjuha

Emetuesit nuk do ta ndalojnë ose ta cenzurojnë një shprehje gjuhsore për arsye se është në gjuhë tjetër, posaqërisht në gjuhë të ndonjë pakice etnike.

#### Seksioni 9 E Drejta për Demant

9.1. Emetuesit do të ofrojnë të drejtën për demant nëse kanë transmetuar material që e paraqet një person, një grup ose një institucion në pozitë të disfavorshme, ose nëse drejtësia dhe paanshmëria e kërkojnë atë. Emetuesit do të sigurojnë që demanti të prezentohet njësoj dukshëm sikurse ka qenë i prezentuar materiali me përmbajtje të disfavorshme.

9.2.Nëse materiali i transmetuar vërtetohet se ka qenë i pavërtetë, emetuesit do të transmetojnë përmirësimin sa më shpejtë që është e mundur. Emetuesit do të sigurojnë që përmirësimi të prezentohet njësoj dukshëm sikurse ka qenë i prezentuar materiali i pavërtetë.

Seksioni 10  
Ankesat e Publikut

Së paku një herë në ditë, emetuesit do të transmetojnë emrin, adresën, numrin e telefonit, të telefaksit nëse posedojnë dhe e-mail adresën e pronarit, të drejtuesit ose të redaktorit që mund t'i drejtohen ankesat.

Seksioni 11  
Arkivi

11.1.Emetuesit do të bëjnë audio dhe video regjistrimet e të gjitha programeve të transmetuara, dhe do t'i ruajnë ato së paku 21 ditë. Këto regjistrime do të jenë në dispozicion të Komisionerit të Përkohshëm për Mediume dhe sipas kërkesës së tij do t'i dërgohen brenda 12 orësh.

11.2.Në rast se Komisionerit të Përkohshëm për Mediume i është dërguar ndonjë ankesë kundër emetuesit, në rast të imponimit të ndonjë sanksioni sipas Seksionit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/36, ose në rast të ankesës kundër ndonjë sanksioni sipas Seksionit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/36, emetuesi duhet të respektojë kërkesën e Komisionerit të Përkohshëm për Mediume për t'i ruajtur regjistrimet sipas nën-Seksionit 11.1 deri sa ajo çështje të zgjidhet përfundimisht.

Seksioni 12  
Zotimi

Me këtë zotohem se do t'u përmbahem normave të këtij Kodi. E kam të ditur se në të kundërtën rezultojnë sanksionet sipas Seksionit 3 të Rregullores.

Vendi/Data

\_\_\_\_\_  
emri i konkuresit

Vendi/Data

\_\_\_\_\_  
emri i dëshmitarit

## **Dispozitat e Licencës së KPM-së për të drejtat e autorit**

### **Udhëzimet për zbatim**

**1 janar 2004**

---

#### **Preambula**

Zbatimi i të drejtës dhe praktikës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e pronës intelektuale, duke përfshirë por jo vetëm video dhe audio materiale zbavitëse, është çështje kyçe për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë dhe sundimin e ligjit në tregun e mediave.

Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e Kornizës Kushtetuese të Kosovës, në nenin 27 deklaron se: “Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë”

Piratëria – prodhimi, shpërndarja, shitja apo emetimi ilegal i materialeve që janë subjekt i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale – është një formë e padrejtë e konkurrencës në tregun e mediave. Piratëria i dëmton interesat e autorëve dhe pronarëve tjerë të të drejtave, rrezikon të provokojë kundërmasa ndërkombëtare në tregëti, vendos në një pozitë të padrejtë ekonomike ata të cilët veprojnë në përputhje me ligjin dhe pengon zhvillimin normal të ekonomisë së tregut.

Licencat që KPM-ja ka lëshuar për të gjithë emetuesit përmbajnë obligimet vijuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së autorit:

*“Është obligim i marrësit të lejes që të sigurojë të gjitha të drejtat e duhura të autorit dhe lejet për të gjitha programet (duke përfshirë muzikën përmes CD dhe format tjera) para se të transmetohen ato programe nga ana e marrësit të lejes. Kjo përfshin riprodhuesin, ritransmetimin dhe përcjelljen e sinjaleve të huaja dhe të importuara, qofshin ato nga emetuesit territorial si edhe nga sinjalet dhe programet e marra përmes satelitit. Në rast se programi legalisht konsiderohet si sferë publike, një leje e tillë nuk kërkohet. Marrësi i lejes pajtohet që t’ia dorëzojë KPM-së kopjet e çdo marrëveshjeje për licencim brenda 72 orëve dhe atë në formë të shkruar.”*

Tani për tani në Kosovë nuk ka ndonjë ligj specifik që e rregullon mbrojtjen e të drejtës së autorit. Në mungesë të një ligji të tillë, sistemet normale për mbrojtjen e të drejtës së autorit për muzikë dhe softver – përfshirë mbledhjen e taksave për përdorimin e muzikës – ende nuk mund të zbatohen në Kosovë.

Megjithatë, subjektet transmetuese janë të detyruara të veprojnë në përputhje me praktikat normale për mbrojtjen e të drejtave të autorit në nivelin më të lartë të mundshëm. Prandaj është e nevojshme dhe praktike që subjektet transmetuese (1) të pajisen me të drejta ligjore për transmetimin e video materialeve përmes kontratave valide me shitësit e autorizuar të filmave dhe materialeve të tjera programuese; dhe (2) të pajisen me të drejta ligjore për ritransmetimin e programeve të marra nga transmetimi satelitor ose burime të tjera përmes kontratave valide me pronarët e programeve të tilla apo përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Prandaj, Komisioneri i Përkohëshëm për Media, brenda mandatit të tij për të rregulluar transmetimin, u kërkon të gjitha subjekteve transmetuese të pajisen me të drejta të tilla kontraktuese dhe të paraqesin kopjet e kontratave pasi t’iu kërkojnë.

Udhëzimet vijuese sqarojnë se si planifikon KPM-ja t’i imponojë dispozitat për mbrojtjen e të drejtave të autorit në licencat ekzistuese të saj. Këto Udhëzime do të mbesin në fuqi derisa të modifikohen nga ana e KPM-së apo agjencisë pasardhëse, Komisionit të Pavarur të Mediave, ose deri me miratimin e ligjit për mbrojtjen e të drejtës së autorit nga ana e Kuvendit të Kosovës.

KPM pranon që një numër i stacioneve televizive lokale transmeton filma dhe materiale të tjera programore të marra nga burime ilegale me çmime shumë të ulëta. Ne gjithashtu e pranojmë se miratimi i një regjimi ligjor – blerja e të drejtave nga shitësit e autorizuar – mundet në masë të madhe të ngrisë çmimin e operimit për stacionet të cilat tani bazohen në matëriale pirate.

Prandaj, KPM parasheh të përcaktoj një periudhë të arsyeshme kalimtare prej 90 ditësh për implementimin e këtyre Udhëzimeve, duke filluar më 1 janar 2004.

KPM inkurajon stacionet që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe me Asociacionin për Media Elektronike në Kosovë (AMPEK) të organizojnë blerjen grupore e të drejtave për pakot e filmave dhe materialeve të tjera programore nga shitësit e autorizuar në regjion.

Me një bashkëpunim të tillë, stacionet individuale që nuk i bëjnë konkurrencë njëra tjetrës mundën në masë të madhe të zvogëlojnë çmimin e video materialeve të fituara në mënyrë ligjore pa ndjerë një disavantazh konkurrues.

Udhëzimet vijuese duhet të kuptohen si një interpretim gjithëpërfshirës çfarë praktika dhe e drejta ndërkombëtare lejon ose ndalon në përdorimin materialeve të mbrojtura nga e drejta e autorit. Këto Udhëzime zbatojnë kërkesën e licencës ekzistuese për çështjet më urgjente dhe specifike në Kosovë të transmetimit pirat të filmave dhe emetimit satelitor.

Kjo rregull do të interpretohet dhe aplikohet në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 të qershorit 1999.

## Udhëzime

### I. Përdorimi i drejtë i materialit të mbrojtur me të drejtë autoriale:

- A. Për qëllime të raportimit të planifikuar të lajmeve dhe vetëm për emitimin informativ dhe arsimor, mediat elektornike mund të përdorin fragmente të shkurtëra të materialeve me të drejtë të mbrojtur autoriale, me kusht që subjektet transmetuese qartazi e përshkruajnë burimin. Në përgjithësi fragmentet e tilla nuk duhet të kalojnë më tepër se 90 sekonda.
- B. Ky standard i “përdorimit të drejtë” nuk duhet të interpretohet në atë mënyrë që të lejohet përdorimi i shumëfishtë dhe në vazhdimësi i materialit të lajmeve të prodhuara nga organizatat e tjera në mungesë të një marrëveshje valide nga pronarët e të drejtave të autorit të materialit ose nga agjentët e tyre të autorizuar. Në asnjë rast një “përdorim i drejtë” i tillë nuk duhet të rrezikojë interesat ekonomike dhe morale të pronarëve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme.

### II. Transmetimi i tërësishëm apo i pjesëve të konsiderueshme të materialit me të drejtë të autorit:

- A. Transmetimi i tërësishëm apo i pjesëve të konsiderueshme të video, audio, ose tekst materialit të mbrojtur me të drejtë të autorit, tejkalimi i standardit të Përdorimit të Drejtë të cituar në Udhëzimin I, pjesa A, lejohet vetëm me një kontratë valide me pronarin e të drejtave të autorit ose me një shitës legalisht të autorizuar të materialeve të tilla.
- B. Përveç kërkesave në paragrafin A, sa i përket emetimit të video, audio, dhe materialeve të tjera të mbrojtura me të drejtën e autorit, KPM-ja kërkon që subjektet transmetuese të sigurojnë gjithë atë material në formë elektronike ose në DVD, kompakt disk, kaseta ose në forma tjera për inçizim në atë mënyrë që respekton obligimet e të drejtave të autorit.

### III. Obligimet e Subjekteve Transmetuese

- A. Ne i përkujtojmë subjektet transmetuese se licencat e KPM-së kërkojnë ruajtjen e arkivës të inçizimeve komplete të programit që ata emitojnë për një periudhë kohore 21 ditëshe. Kushtet e lejes gjithashtu kërkojnë nga subjektet transmetuese që t'i ofrojnë KPM-së kopjet e kontratave që tregojnë se ata posedojnë të drejta ligjore për ta emetuar materialin e mbrojtur me të drejtë autoriale. Kërkohet nga subjektet transmetuese që të ofrojnë këto kontrata brenda 72 orëve ose 3 ditëve nga kërkesa e KPM-së.

### IV. Sanksionet në rast të mospërmbushjes së kësaj Rregulle

- A. Sanksionet për shkelje të dispozitave të të drejtave të autorit të licencave të KPM-së duhet të vendosen nga KPM-ja në mënyrë korrekte dhe të duhur, duke marrë në konsideratë përpjekjet e subjektit transmetues për zbatimin e këtyre Udhëzimeve. KPM-ja do t'i përcjellë procedurat e veta për shqyrtimin e rasteve në përputhje me Nenet 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/36 dhe në bazë të Rregullave të Procedurës së Komisionerit të Përkohshëm për Media.

- B. KPM do ta lejojë një periudhë fillestare kalimtare prej 90 ditësh, nga data e hyrjes në fuqi të këtyre Udhëzimeve, gjatë së cilës do të pritët nga subjektet transmetuese që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i arritur këto kushte, sa iu përket të gjithë filmave apo emisioneve tjera që ata i transmetojnë. Gjatë kësaj periudhe 90-ditëshe, KPM-ja mund të nxjerr vërejtje për mos zbatimin e këtyre Udhëzimeve, por jo dënime financiare.
- C. Pas periudhës prej 90 ditëve, shkelja e parë e këtyre Udhëzimeve në përgjithësi do të rezultojë me një vërejtje zyrtare. Megjithatë, një dënim financiar mund të imponohet ndaj një stacioni i cili ka pranuar vërejtje më parë dhe i cili nuk ka treguar progres në zbatimin e këtyre Udhëzimeve.
- D. Dënimet financiare mund të llogariten si një shumëfish i çmimit komercial të transmetimit të produktit/eve në fjalë. Ky çmim do të caktohet nga KPM-ja në konsultim me shitësit relevant. Dënimi i parë financiar do të jetë dyfishi i vlerës komerciale i të drejtës për transmetim për produktin në fjalë.

#### **V. Data e hyrjes në fuqi**

- A. Data e hyrjes në fuqi e këtyre Udhëzimeve është 1 Janari 2004. Më 31 mars 2004 përfundon periudha kalimtare dhe pastaj këto Udhëzime janë plotësisht të zbatueshme.

Robert Gillette  
Komisioner i Përkohshëm për Media





## Rregullorja e KPM-së 2005/1

### Cilësitë për Marrjen e Licencës së Transmetimit

- 1. Qëllimi:** Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë cilësitë minimale që kërkohet të plotësojnë kandidatët për Licencë të re dhe zotëruesit e licencave ekzistuese. Në vlerësimin e kërkesave të paraqitura për dhënien e Licencës së KPM-së do të zbatohen kritere më rigorozë në përshtatje me tenderin konkurrues për Licencë.
- 2. Synimet Politike:** Paragrafi 2.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 kërkon që KPM-ja të marrë parasysh interesat publike në dhënien e licencave të transmetimit. Në këtë kontekst KPM-ja i përcakton interesat publike në kuptimin që licencimi duhet të inkurajojë vlerat demokratike, profesionalizëm më të madh, shumëllojshmëri të përmbajtjes së programit dhe qëndrueshmëri financiare të mediave elektronike, për të mbrojtur lirinë e të shprehurit duke siguruar transparencë të pronësisë së medias, dhe të stimulojë ekonominë e tregut nëpërmjet reklamave komerciale.
- 3. Kompetenca:** Paragrafi 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 kërkon që KPM-ja të krijojë një regjim rregullativ të përkohshëm. Paragrafi 2.2 i jep kompetenca KPM-së të dekretojë procedurat e kërkesave për licenca transmetimi dhe për dhënien e tyre.
- 4. Zbatimi:** Cilësitë për Licencë të KPM-së do të zbatohen për të gjitha licencat e dhëna nga KPM-ja.
- 5. Përcaktime:**
  - A. Licencë:** Licenca është leje e kushtëzuar, kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për përdorimin e një ose më shumë frekuencave të përcaktuara për transmetime radioje ose televizive. I Licencuari, me marrjen e Licencës së KPM-së, pajtohet me të gjithë ligjet që kanë lidhje me to, rregulloret e UNMIK-ut, rregulloret dhe udhëzimet zyrtare të KPM-së dhe kushtet teknike të përgjithshme dhe specifike të Licencës.
  - B. I Licencuari:** I Licencuari është person juridik të cilit i jepet një Licencë e KPM-së. I Licencuari mund të jetë:
    1. Individ që është banues i rregullt i Kosovës;
    2. Kompani private e regjistruar ku përfshihen, por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje

aksionere ose me përgjegjësi të kufizuar, ose Ndërmarrje me Pronësi Shtetërore ose me Pronësi Shoqërore;

3. Organizatë Jo Qeveritare e regjistruar në bazë të ligjit

**C. Pronësi:** Zotërimi i një personi fizik ose juridik ose të më shumë se 10 përqind të pjesës së kapitalit bazë të një organizate emetuese ose të pajisjeve të saj.

**D. Kandidat:** Kandidat është çdo person juridik që bën kërkesë për dhënie të një licence të re të KPM-së në kohën që KPM-ja ka shpallur konkurs për licencë, ose ai që kërkon miratim për transferimin e një licence ekzistuese ose miratimin për marrjen e një pjese të pronësisë tek një i licencuar ekzistues.

**E. Agjent:** Agjent është një individ që përfaqëson dhe zbaton udhëzimet e një pale të tretë, përfshirë, por nuk kufizohet me to, të organizatave politike.

**6. Cilësitë për një Licencë:** Kandidati duhet të garantojë me shkrim që i përmbahet cilësive që vijojnë:

**A. Prezencë të ligjshme në Kosovë:**

1. Individu duhet të jetë banor i rregullt i ligjshëm i Kosovës që zotëron dokument identifikimi të vlefshëm dhe të pranueshëm;
2. Organizata jo fitimprurëse ose i licencuari komercial duhet të jenë fizikisht të pranishëm në Kosovë dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e Kosovës që lidhen me to.

**B. Cilësitë Profesionale:**

1. Kandidati për Licencë duhet të tregojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një stacion transmetues në përputhje të plotë me rregulloret e KPM-së duke përfshirë dhe Kodin e Sjelljes për Mediat Elektronike, kushtet dhe termet e Licencës së KPM-së, kushtet dhe termet e licencave të KPM-së dhe standardet teknike;
2. Kandidatët duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi të marrin programe komerciale në mënyrë ligjore;
3. Kandidatët duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi të vënë në funksion një stacion radioje apo televizioni si biznes, qoftë për fitim ose si organizatë jo fitimprurëse.

**Raporti me Taksat:**

Kandidati duhet të jetë përputhje me të gjitha ligjet për taksat në Kosovë. Konstatimi i një shkeljeje lidhur me taksat mund të shërbejë si bazë për mosdhënie të Licencës së transmetimit.

**Zbatimi për Pronarët e Mediave të tjera në Kosovë:**

Inkurajimi i shumëllojshmërisë dhe i konkurrencës në tregun e mediave në Kosovë në shkallë lokale, rajonale dhe mbarëkosovare është politikë e KPM-së. Cilësitë për një Licencë të re ose ekzistuese mund të rregullohen me anë të një Rregulloreje për koncentrimin e mediave.

## **Zbatimi për Pronësinë e Huaj:**

Pronësia e huaj e një licence transmetimi lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale me prani të regjistruar ligjërisht në Kosovë në përputhje me Ligjin në zbatim.

## **Arsyet e Skualifikimit për marrjen e Licencës:**

**Entet Qeveritare:** Është politikë e KPM-së që të mos u japë Licenca transmetimi agjensive qeveritare ose ndërmarrjeve ose enteve të tjera në të cilat qeveria ka ndikim në kontrollin e tyre.

**Individë që janë të Zgjedhur ose të Emëruar në një Funkcion Zyrtar:** Nuk do ti jepet Licencë individëve të zgjedhur ose të emëruar në një funksion zyrtar; nuk do ti jepet Licencë një OJQ-je, kryetari, nënkryetari ose drejtori ekzekutiv i të cilës janë të zgjedhur ose të emëruar në funksione zyrtare; nuk do t'i jepet Licencë një kompanie në të cilën pronësia e shumicës së aksioneve i përkasin një personi të zgjedhur ose të emëruar në funksion zyrtar, përveç rasteve kur një person i tillë ka dhënë zyrtarisht dorëheqje nga menaxhimi i entit transmetues. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet ndaj individëve të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës.

**Individët që kanë pozita drejtuese në një Parti Politike:** Dispozitat e Paragrafit 7 do të zbatohen njësoj për të gjithë individët që janë të zgjedhur ose janë të emëruar në një post drejtues brenda një partie politike.

**Organizatat dhe Kompanitë e Lidhura me Partitë Politike:** Nuk do t'i jepet Licencë një OJQ-je ose organizate komerciale që në mënyrë të hapur i kushtohet mbështetjes së një partie politike.

**Moszbatim i mëparshëm i rregulloreve të KPM-së:** Shkelje serioze dhe të përsëritura të rregulloreve të KPM-së nga një organizatë medie e cila është në pronësi, drejtohet ose financohet nga kandidati mund të përbëjë një bazë për refuzim të një Licence të KPM-së të re ose të transferuar ose aprovimin për marrjen e një pjese të pronësisë. Shkelje të tilla mund të merren si fakte të paaftësisë ose mosdashje të vënies në funksion të një stacioni transmetues në përputhje me rregulloret e KPM-së.

**Lidhja me Paragjykime Etnike ose fetare:** Nuk do t'i jepet Licencë ose pronësi i një të licencuari çdo individ, organizate ose ndërmarrjeje komerciale që ka qenë e lidhur me shpërndarjen e materialeve që nxisin urrejtje ose diskriminim ose që denigrojnë persona në bazë të përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose të paaftësisë fizike.

**Dënimi Penal:** Asnjë individ i cili është shpallur fajtor për një krim të rëndë ose për veprë penale të mashtrimit ose vjedhjes nuk do t'i jepet Licencë ose marrja e pronësisë së një pjese tek një i licencuar dhe nuk do t'i jepet Licencë asnjë organizate në të cilën një person i tillë shërben si zyrtar ose drejtues kryesor.

**Agjentët e të Licencuarit Potencial:** Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen plotësisht dhe njësoj tek çdo individ, organizatë ose kompani që vepron si agjent i një të licencuari potencial.

**Kërkesa me Pretendime të Pavërteta:** Neglizhimi i një kandidati ose të licencuari për të zbuluar informacione që mund ta bëjnë KPM-në që të refuzojë miratimin për modifikimin ose transferimin e një licence ose të pjesës së pronësisë së një të licencuari, në bazë të kushteve të kësaj Rregulloreje mund të ketë si pasojë dënime të mëvonshme, përfshirë edhe skualifikimin për marrje të Licencës ose heqjen e Licencës.

**Ndryshim i Rrethanave të të Licencuarit:** Çdo ndryshim në gjendjen e individëve, zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që zotërojnë Licencë të KPM-së ose pjesë pronësie, që ka si pasojë skualifikimin e tyre për Licencën, duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve pune nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i skualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur u bë për skualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrregullimit të operimit të emetuesit.

**Ankimi për Refuzimin:** Çdo kandidat të cilit i është refuzuar dhënia e një Licencë ose atij që i është refuzuar aprovimi për pronësi të një pjese të një licence mund të ankohet në Bordin e Mediave për Ankesa brenda 30 ditëve nga dita e refuzimit nga ana e KPM-së.

**Dispozita Kalimtare:** Kjo Rregullore do të zbatohet menjëherë tek kandidatët e rinj për Licencë të KPM-së. Ajo do të zbatohet tek të gjithë licencat e dhëna nga KPM-ja deri tani, e kjo datë do të përcaktohet nga Komisioneri i Përkohshëm për Media.

[Miratuar më: 25 prill 2005]



## MEMORANDUM

25 prill 2005

### **Licenca e re e KPM-së: Përmbledhje sqaruese**

KPM-ja ka filluar t'u lëshojë licenca të reja të gjithë transmetuesve aktualë të radiove dhe televizioneve.

Licenca e re nuk imponon asnjë barrë të re të operimit apo barrë ekonomike ndaj transmetuesve. Megjithatë, ne besojmë se licenca e re është më e qartë, më gjithëpërfshirëse dhe më profesionale se licenca aktuale e KPM-së.

#### **I. Pse duhet një licencë e re e KPM-së?**

Kjo është një pjesë e përgatitjeve tona për tranzicion në agjensionin e përhershëm rregullativ Kosovar i cili operon sipas praktikave më të mira Evropiane-Komisioni i Pavarur për Media.

Për një sektor medial të shëndoshë e produktiv të ekonomisë kosovare është e nevojshme që transmetuesit t'i njohin mirë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Licenca duhet të përkufizojë në mënyrë të qartë e gjithëpërfshirëse rregullat dhe detyrimet e zbatueshme për stacionet radiofonike dhe televizive gjatë veprimtarisë së tyre të përditshme.

Ne kemi studiuar me vëmendje rregulloren e licencave të KPM-së dhe kemi vërejtur se ky dokument përmban pasaktësi që ndikojnë në dobësimin e aftësive të KPM-së për të rregulluar transmetimet në përputhje me praktikatat më të mira evropiane. Gjithashtu këto pasaktësi janë në dëm të vetë transmetuesve.

#### ***Më saktësisht:***

Qysh prej vitit 2000, KPM-ja ka nxjerrë të paktën tri tekste të ndryshme të licencave. Kjo do të thotë se jo të gjithë transmetuesit janë subjekt i kërkesave të njëjta ligjore. Kjo gjë është një shkelje flagrante e parimit të sundimit të ligjit.

Ka ndryshime në përkthim mes versioneve në anglisht dhe shqip të teksteve të licencave.

Tekstet e licencave përmbajnë kundërshtime dhe paqartësi që i bëjnë ato të vështira për t'u interpretuar dhe zbatuar. Në një aspekt licencat janë në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/36, aspekt ky që do t'i bënte ato të pavlefshme.

Tekstet e licencave janë të formuluar keq me paragrafe të panumëruara, duke bërë që rregulloret të jenë të vështira për t'u kuptuar dhe mbajtur mend.

Por çka është më e rëndësishme, licencat nuk trajtojnë shumë çështje thelbësore rregulluese.

Ne besojmë se është e domosdoshme që licencat të bëhen më profesionale dhe më të qarta brenda një kohe sa më të shkurtër me qëllim që në të ardhmen Komisioni i Pavarur i Mediave të ketë një bazë të sigurtë e të qartë ligjore për veprimtarinë e tij rregulluese.

Për këto arsye, ne kemi përgatitur licencë të re të KPM-së.

## **II. Përmbledhje: Licenca e re**

Licencat e vjetra të KPM-së (në parim) përbëheshin prej dy pjesëve: Kushtet dhe Kërkesat e Përgjithshme, të cilat përcaktojnë rregullat e zbatueshme për të gjithë transmetuesit; dhe Standartet Teknike, Kushtet dhe Referencat, të cilat saktësojnë parametrat teknikë për secilin stacion, siç janë frekuenca, vend-ndodhja e aparatit transmetues dhe karakteristikat e antenës transmetuese. Praktikisht, shumë prej transmetuesve kurrë nuk e kanë marrë këtë dokument.

### ***Licenca e re e KPM-së përbëhet prej 5 pjesëve:***

**Dëshmia e Licencës:** Një fletë e vetme që mund të vendoset në mur për të dëshmuar se transmetuesi është pajisur me licencë të KPM-së.

**Pjesa 1 – Kushtet dhe Kërkesat e Përgjithshme të Licencës:** Versioni i ripunuar i kushteve të tanishme të licencës që zbatohen për të gjithë transmetuesit.

**Pjesa 2 – Kushtet dhe Kërkesat Teknike të Licencës:** Tabela e detajuar e kushteve teknike të aprovuara, siç janë niveli i fuqisë, vend-ndodhja e saktë dhe karakteristikat e antenave transmetuese, si dhe kërkesa të tjera të veçanta për secilin stacion. Pjesa 2 gjithashtu përcakton se kush e ka stacionin në pronësi, si dhe kushte e kërkesa të tjera të licencës së tij.

**Pjesa 3: Skema Programore e Licencës:** Përmbledhja koncize e skemës programore dhe elementeve për të cilat është dhënë licenca. Pëlqimi i KPM-së është i nevojshëm për ndryshime thelbësore të skemës programore në mënyrë që stacioni të vazhdojë t'i shërbejë atyre interesave të veçanta të publikut, për të cilat i është dhënë licenca.

**Pjesa 4: Harta e Zonës së Mbulimit:** Harta topografike e kompjuterizuar që tregon zonën e mbulimit të stacionit të parashikuar me licencë.

Përveç kësaj, nga transmetuesit do të kërkohet të kompletojnë një formë të quajtur “Deklarimi i Pronësisë” për të sqaruar statusin e pronësisë të secilit të licencuar.

## **III. Shpjegimet**

Vijon një komentuar shpjegues i secilës prej pjesëve të licencës së re.

**Pjesa 1 – Kushtet dhe Kërkesat e Përgjithshme:** Rregullat themelore të aplikueshme për të gjithë emetuesit.

**1.0 Përkufizimet:** Licencat ekzistuese të KPM-së nuk përmbajnë përkufizime të termave ligjorë të rëndësishëm. Përkufizimet janë të nevojshme për shprehjen e qartë të mendimit.

**2.0 Dhënia e Licencës:** Licencat e vjetra të KPM-së nuk thonë asgjë për afatin e vlefshmërisë së tyre.

**3.0 Zbatimi:** Ky nen përcakton kornizën ligjore të licencës, përfshirë këtu kushtet themelore që duhen përmbushur prej transmetuesit dhe KPM-së.

3.1: Përshtatur nga licencat ekzistuese.

3.2: Përshtatur nga licencat ekzistuese.

3.3: Shtohet një dispozitë që i detyron transmetuesit të zbatojnë menjëherë udhëzimet e ligjshme të KPM-së, përfshirë këtu mënjanimin e interferencave të shkaktuara prej tyre.

3.4: Shtohet një dispozitë që i detyron transmetuesit të transmetojnë informata në rast emergjence dhe porosi të tjera të cilat konsiderohen të domosdoshme për interesat publike nga PSSP-ja apo Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

3.5: Shtohet një detyrim që i detyron transmetuesit të sigurojnë qasje në ambientet e tyre për qëllime të inspeksionit të KPM-së në rast të një problemi rregullues.

3.6: Shtohet një detyrim që secili transmetues që financohet prej fondeve publike duhet të paraqesë një raport vjetor për mënyrën se si janë përdorur ato. Këto raporte duhet të verifikohen prej organit rregullues të transmetimeve.

3.7: Shtohet një dispozitë në licencat e KPM-së që parashikon se Kodi i Sjelljes i Mediave Elektronike zbatohet për të gjitha programet e transmetuara, pa marrë parasysh nëse transmetuesi e prodhon atë apo e merr nga burime të tjera.

3.8: Fuqizohet një dispozitë në licencat ekzistuese të KPM-së, e cila do t'i sigurojë transmetuesit mundësi të drejta dhe të plota, kur përgjigjet për ndonjë shkelje të pohuar të rregullave të KPM-së.

3.9: Sqaron dispozitat ekzistuese në licencat e KPM-së.

**4.0 Dispozitat operative:** Ky nen përcakton detyrimet rregulluese për veprimtarinë e përditshme të stacioneve radiofonike dhe televizive.

4.1: Dispozitat e së drejtës së autorit nuk kanë pësuar ndryshime krahasuar me licencat ekzistuese.

4.2: Kërkesat e arkivimit nuk kanë pësuar ndryshime krahasuar me licencat ekzistuese, përveçse sqarohet se inqizimet mund të ruhen në format digjital.

4.3: Sqarohen informatat që transmetuesit duhet t'i paraqesin KPM-së në raste ndryshimesh. Njoftimi për ndërprerjet e programit është i nevojshëm vetëm për ndërprerjet njëditore dhe jo për ato gjysmëditore siç parashikohet në licencat ekzistuese. Është shtuar një dispozitë që i detyron transmetuesit të njoftojnë KPM-në për ndryshime eventuale në statusin e pronësisë apo të të licencuarit që mund të rezultojë me skualifikim për licencë sipas rregullave të KPM-së rreth Kualifikimeve për Licencë (bashkangjitur ndarazi).

4.4: Zgjatet në 90 ditë (nga 45 ditë siç parashikohej në licencat ekzistuese) afati, brenda të cilit licenca, ose një amendament në licencë, duhet vënë në zbatim.

4.5: Sqarohet se licencat jepen për një përdorim 24-orësh të frekuencave dhe se koha reale e transmetimit nuk mund të jetë më pak se gjashtë orë në ditë, prej orës 06:00 deri në 24:00.

4.6: Shtohet një dispozitë që i jep të drejtë transmetuesve të lidhin kontratë me një palë të tretë (siç mund të jetë KTTN) për të vënë në funksion antenat e tyre transmetuese, por shton se të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e licencave i takojnë stacionit radiofonik apo televiziv.

4.7: Sqarohen detyrimet e ndryshme për identifikimin e stacioneve radiofonike dhe televizive.

4.8: Shtohen dispozita që mbrojnë shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve dhe publikut.

4.9: Shtohet një dispozitë që sqaron se ndërprerjet e vazhdueshme e të zgjatura të programit mund të çojnë në revokimin e licencës. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur ndërprerja e programit shkaktohet prej mungesës së energjisë elektrike (Shih Nenin 8), por ka për qëllim të trajtojë problemet e stacioneve radiofonike apo televizive që për shkaqe të brendshme janë të paafta të sigurojnë një shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve publike, siç mund të jetë një frekuencë e licencuar.

4.10: Sqarohet një referencë e vjetruar në licencat ekzistuese e një tarife licencimi të 2001-shit.

4.11: Përmban një detyrim shtesë, të përcaktuar në Pjesën 3 të licencave të reja, lidhur me skemën programore që i përmbahet programit të paraqitur në kërkesën e transmetuesit për licencë, mbi të cilin bazohej vendimi i KPM-së për dhënien e licencës. Ky nen dhe Pjesa 3 bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/36, Neni 2.3, që e detyron KPM-në të ketë parasysh interesat publike gjatë dhënies së licencave. Për pasojë, dhe kështu duhet përcaktuar shprehimisht në licencë, mediat duhet t'i shërbejnë interesave publike, për të cilat atyre edhe i është dhënë licenca. Kjo kërkesë nuk lejon ndryshime thelbësore në skemën programore pa pëlqimin paraprak të KPM-së.

**5.0 Përdorimi dhe Mënyrat e Transferimit të Licencës:** Ky nen sqaron natyrën e licencës së KPM-së dhe kushtet në të cilat statusi i pronësisë së një stacioni të caktuar mund të aprovohet apo jo nga KPM-ja.

5.1: Parashtrohet se licenca është një kontratë me kusht që i jep të drejtë transmetuesit të përdorë, por jo të zotërojë apo shesë një frekuencë që është një burim publik.

5.2: Sqarohen dispozitat e licencave ekzistuese lidhur me pëlqimin paraprak të KPM-së për ndonjë ndryshim të rëndësishëm të pronësisë. Parashikon ndryshime për të licensuarit e regjistruar si shoqëri aksionare dhe OJQ.

5.3: Sqarohen licensat ekzistuese për të mos i lejuar transmetuesit që të ruajnë pronësinë simbolike të një stacioni radiofonik apo televiziv, ndërkohë që realisht ia kanë kaluar kontrollin e tij efektiv një pale të tretë të palicencuar.

5.4: Vlefshmëria e licencave kushtëzohet nga aftësia aktuale e një transmetuesi për t'i plotësuar kushtet e licencimit, në bazë të Rregullores së KPM-së për Kualifikimet për Licencë (bashkangjitur). Këto rregulla përkufizojnë pronësinë e një stacioni dhe vënë kushte të caktuara për kualifikimin apo moskualifikimin për licencë.

Në rrethana të caktuara, kur preken interesat publike, KPM-ja mund të kërkojë që kalimi i pronësisë së një licence të diskutohet në një seancë publike apo të shpallet tender për licencën.



5.5: Shpjegohet se një licencë frekuence e KPM-së nuk është pasuri që përfshihet në një proces falimentimi apo trashëgimie në rast vdekjeje të titullarit individual të licensës.

**6.0 Ndryshimi i Licencës:** Ky nen tregon se si transmetuesit mund të kërkojnë ndryshimin e licencës së tyre dhe i jep autoritet të kufizuar KPM-së për të filluar procedurat për ndryshimin e licencave në mënyrë që të “garantohet një administrim i rregullt i spektrit të frekuencave”.

**7.0 Sanksionet për Shkeljen e Licencës dhe Rregulloreve të KPM-së:** Ky nen sqaron disa çështje të lidhura me sanksionet dhe disa paqartësi që kanë dalë në pah në licencat ekzistuese.

7.1 Deklaron sanksionet që aktualisht janë të aplikueshme ndaj transmetuesve sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/36.

7.2 Inkorporon dhe sqaron dispozitat në licencat ekzistuese në rastin kur KPM-ja sekuestron pajisjet e një stacioni të caktuar.

7.3 Ripërsërit dispozitat e licencave ekzistuese, me përjashtim të njëjës që parashikonte mbledhjen në sesion të Bordit të Mediave për Ankesa brenda 24 orëve, e cila është eliminuar për shkak se ishte e pazbatueshme dhe e panevojshme. (Një situatë e tillë nuk është paraqitur ende.)

**8.0 Forca Madhore:** Shtohet një dispozitë sipas të cilës KPM-ja do të marrë parasysht rastet e forcës madhore (rrethana të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të transmetuesve) gjatë vlerësimit të shkeljeve të licencës.

8.1: Rendit rrethanat e jashtëzakonshme sipas së cilave transmetuesit nuk do të mbajnë përgjegjësi për ndërprerjen e transmetimit apo përndryshe një pamundësi për të respektuar licencën.

8.2: Sqaron se detyrimi i një transmetuesi për pagimin e tarifës së licencës vazhdon përkundër rrethanave që mund të shkaktojnë ndërprerjen e përkohshme të transmetimeve të tij. (Taksa e licencës synon që të mbulojë koston e rezervimit të një frekuence për nevoja të transmetuesit. Frekuenca rezervohet për sa kohë që tarifa e licencës paguhet.) As prishjet e vogla të pajisjeve nuk do të justifikojnë mospërmblidhjen e licencës, përfshirë këtu kërkesën për të ruajtur një arkiv 21-ditor të programeve në tërësi.

**9.0 Gjuha:** Shtohet një dispozitë që shpall se nëse ka mosmarrëveshje rreth përkthimit të licencës do të merret për bazë versioni në gjuhën angleze.

## **Pjesa 2 e Licencës së KPM-së: Kushtet dhe Kërkesat Teknike**

Pjesa 2 është një tabelë e përbërë prej 27 kategorive të të dhënave që përkufizojnë kushte dhe kërkesa teknike specifike për veprimtarinë e secilit stacion radiofonik apo televiziv. Një dokument me të dhënat e Pjesës 2 lëshohet për secilin transmetues të përdorur prej mediave elektronike.

Ky dokument specifikon pajisjet që një stacion radiofonik apo televiziv mund të ndryshojë pa pëlqimin paraprak të KPM-së (siç mund të jenë adresa e studiove apo numri i telefonit), me kusht që ta njoftojë KPM-në pa kaluar 5 ditë-pune nga ky ndryshim.

Pjesa 2 gjithashtu specifikon pajisjet që një stacion radiofonik apo televiziv nuk mund t'i ndryshojë pa pëlqimin paraprak të KPM-së.

Pika 27 përmban kushte specifike shtesë të licencës së stacionit radiofonik apo televiziv, përfshirë këtu një përmbledhje pronësie të të licencuarit (nëse i licencuari është person juridik), si dhe kushte të tjera specifike.

### **Pjesa 3 e Licencës së KPM-së: Skema Programore**

Pjesa 3 është një tabelë e llojeve të skemave programore (shërbim publik, argëtim) dhe burimeve programore (prodhime vetjake, komerciale të jashtme apo ritransmetime) dhe hapësirën e përafërt që ato zënë në totalin e programeve të transmetuara.

Këto elemente duhet t'i përmbahen përgjithësisht strukturës programore të propozuar në kërkesën për licencë të transmetuesit.

Transmetuesi është i detyruar të marrë pëlqim për ndryshime madhore (dhe jo për ato të vogla apo të përkohshme) në strukturën dhe skemën programore. Qëllimi i kësaj kërkesë është që të sigurojë që transmetuesi t'i përmbahet në vija të përgjithshme formatit dhe strukturës së programit, mbi të cilën bazohen dhënia e licencës dhe përdorimi i spektrit të frekuencave, me qëllim që të vazhdohet t'i shërbehet interesit publik që ka qënë parësor në dhënien e licencës.

KPM-së nuk i interesojnë ndryshimet e vogla apo të përkohshme të skemës programore. Kërkesat e pjesës 3 synojnë që të sigurojnë që programi të cilin i Licencuari aktualisht e transmeton në përgjithësi është konform me strukturën dhe përmbajtjen e programit të përshkruar në aplikacionin e të Licencuarit.

### **Pjesa 4 e Licencës së KPM-së: Harta e Zonës së Mbulimit**

Pjesa 4 është një pamje dixhitale e një harte topografike të pjesëve të Kosovës që i licencuari është i autorizuar t'i mbulojë. Harta do të sigurohet prej KPM-së në kuadrin e veprimtarisë së administrimit të frekuencave. KPM-ja do të mbështesë kërkesat e transmetuesve për të përmirësuar përhapjen e sinjalit brenda zonës së tyre të licencuar apo "hartës" së mbulimit.

### **Kualifikimet për Licencë: (Rregulla 2005/1)**

Në konsultim me transmtuesit KPM ka formuar një grup të qartë dhe gjithëpërfshirës të kualifikimeve për Licencë që janë konform me praktikën më të mira Evropiane.

Është e nevojshme që të sqarohen kushtet minimale për marrjen e licencës së transmetimit dhe ata faktorë që mund ta skualifikojnë një aplikant prej marrjes së licencës. Këto kualifikime gjithashtu sigurojnë një përkufizim më të qartë të pronësisë në krahasim me të kaluarën.

Në rastin kur një pronar stacioni radiofonik apo televiziv (dhe titullar i licensës) nuk i plotëson këto kushte, për shembull se është i zgjedhur në funksione publike, KPM-ja do t'i japë atij kohë të mjaftueshme për ta transferuar pronësinë e stacionit sipas kushteve të kësaj rregulle, me qëllim që të parandalohet apo minimizohet çnormalizimi i veprimtarisë së stacionit.

Ky rregull nuk synon që t'i privojë stacionet prej licencave të tyre aktuale, por vetëm që të vendosë standarte të qarta minimale.

[fund]

[Rishikuar më, 25 prill 05]



KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA  
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE  
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

## CERTIFIKATA E LICENCËS

Në bazë të Nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 për Licencimin dhe Rregullores për Mediat Elektronike në Kosovë Komisioneri i Përkohshëm për Media me anë të kësaj i jep:

**[Emri i të licencuarit]**

*këtë licencë për të vënë në funksion stacionin [Emri]*

*për transmetimin tokësor të programeve [radio/televizive]*

*në [frekuencën ose kanalin] të vendosur zyrtarisht në [Emri i zonës urbane/qytetit]*

*në [Komuna]*

Këtë Licencë e përbëjnë dokumentat e më poshtme, që i bashkangjiten kësaj Licence:

**Pjesa 1: Kushtet dhe Termet e Përgjithshme**

**Pjesa 2: Kushtet dhe Termet Teknike**

**Pjesa 3: Format i Programit të Licencuar**

**Pjesa 4: Harta e Zonës së Licencuar**

Kjo Licencë i jepet **[Emri i të Licencuarit]** më **[data]** deri në kohën kur ajo mund të ndryshohet, të përfundohet ose të zëvendësohet në përputhje me rregullat e Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm për Media ose pasardhësit të ligjshëm të tij.

**Robert Gillette**  
**Komisioneri i Përkohshëm për Media**

**Naile Selimaj**  
**Zyrtare e Lartë për Licencim**



## **Pjesa 1: Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së**

### **1.0 Përkufizime:**

- 1.1 KPM-ja dhe Zyra e KPM-së:** Me Komisioner të Përkohshëm për Media dhe Zyrë të Komisionerit të Përkohshëm për Media do të kuptojmë ato institucione siç janë themeluar nga Rregulloret e UNMIK-ut 2000/36, 2000/37 dhe që lidhen me Udhëzimet Zyrtare dhe Vendimet Ekzekutive të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP.)
- 1.2 Rregulloret e KPM-së:** Me Rregullore të KPM-së do të kuptojmë të gjitha qëndrimet për të drejtat dhe detyrat e emetuesve në Kosovë të shpallura nga PSSP dhe/ose nga Komisioneri i Përkohshëm për Media që lidhen me emetuesit e radios dhe të televizionit.
- 1.3 I Licencuar:** Me të Licencuar do të kuptojmë emetuesin e radios ose të televizionit të cilit KPM-ja i jep Licencë dhe të drejtën e përdorimit të frekuencës(ave) që lidhet me të.
- 1.4 Stacion:** Me Stacion do të kuptojmë njësinë fizike dhe personelin e të Licencuarit të cilët realizojnë transmetimin me Licencë KPM-je; pra emetuesin.
- 1.5 Program:** Me Program do të kuptojmë përmbajtjen audio-vizuale të emetimit të transmetuar nga i Licencuari, duke përfshirë edhe reklamat.
- 1.6 Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës:** Me Kushte dhe Terme të Përgjithshme të Licencës do të kuptojmë të drejtat dhe detyrimet e të Licencuarit të zbatueshme për të gjithë emetuesit e radios dhe televizionit.
- 1.7 Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës:** Me Kushte dhe Terme Teknike të Licencës, që përbëjnë Pjesën 2 të licencave të KPM-së, do të kuptojmë parametrat e punës të një stacioni të vetëm, që përfshijnë frekuencën, vendndodhjen, nivelin e lejuar të fuqisë, karakteristikat e antenës dhe informacione të tjera teknike të specifikuar në Tabelën që i është dhënë stacionit nga KPM-ja si një pjesë përbërëse e licencës së tij.
- 1.8 Format i Programit të Licencuar:** Me Format të Programit të Licencuar do të kuptojmë përbërësit e programit të emiterit siç specifikohet në Pjesën 3 të Licencës.
- 1.9 Harta e Zonës së Programit:** Me Hartë të Zonës së Programit, Pjesa 4 licencës së KPM-së, do të kuptojmë një figurë digjitale të prodhuar nga KPM-ja që përshkruan zonën topografike të Kosovës që i Licencuari është i autorizuar për ta mbuluar.

## 2.0 Dhënia e Licencës:

**1.1 Kohëzgjatja e Licencës:** Licenca do të jetë e vlefshme deri kur ndryshohet ose përfundohet nga KPM-ja ose zëvendësohet nga një Licencë e dhënë nga KPM-ja ose pasardhësi ligjor i tij.

## 3.0 Pajtueshmëria:

**3.1 Natyra e Licencës:** Pranimi i kësaj Licence përbënë një kontratë të detyrueshme për të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Rregulloren 2000/36 si dhe me kushtet dhe termet e saj dhe me të gjitha Pjesët e tjera të Licencës së KPM-së, si dhe me të gjitha rregulloret, kodet e sjelljes dhe direktivat dhe urdhërat ligjore të nxjerra nga Komisioneri i Përkohshëm për Media ose ndonjë organ kompetent ligjor tjetër, përveç rasteve kur i Licencuari përjashtohet veçanërisht nga KPM-ja me shkrim nga dispozita të tilla.

**3.2 Vlefshmëria e Licencës:** Vlefshmëria e kësaj Licence bëhet e mundëshme kur veprohet në përputhje me kushtet dhe termet e saj si dhe me dokumentat ligjorë të cituar në 3.1. Shkeljet e rënda të kësaj Licence, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to, transferimin e paautorizuar të pronësisë ose të kontrollit të Licencës dhe të frekuenc-ës(ave) që lidhet me të, mund të çojnë në anulim të Licencës.

**3.3 Përputhja me urdhërat:** I Licencuari duhet të veprojë menjëherë në përputhje me të gjitha urdhërat dhe udhëzimet e ligjëshme të dhëna nga KPM-ja për të vënë në zbatim rregulloret për transmetimet duke përfshirë, por nuk kufizohen me një urdhër të KPM-së për të korrigjuar të metat teknike në sinjalin e transmetimit të stacionit që mund të shkaktojë ndërhyrje me përdorues të tjerë të autorizuar të spektrit të frekuencës.

**3.4 Njoftimet të shërbimit publik:** I Licencuari duhet të transmetojë njoftimet të shërbimit publik siç janë ato të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose të Zyrës së Kryeministrit që konsiderohen të nevojshme dhe urgjente për interesat e rendit publik.

**3.5 Hyrja në ndërtesa:** I Licencuari duhet të lejojë çdo person të autorizuar me shkrim nga KPM-ja të hyjë në ndërtesat që i licencuari mund t'i përdorë për transmetim, prodhim programesh ose si zyre, me qëllim për inspektim ose kontrollin e të gjitha regjistrimeve ose pajseve, ose të testojë të gjitha pajisjet, me qëllim që të verifikojë përputhjen me kërkesat rregullative të ligjshme të KPM-së.

**3.6 Fondet publike:** I Licencuari që merr fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ose nga të tjera taksa publike të detyruara që zbatohen në Kosovë duhet që çdo vit të përgatisë një raport financiar publik për përdorimin e këtyre fondeve, dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit dhe revizionit të KPM-së.

**3.7 Përputhja me Kodin e Sjelljes:** I Licencuari mban përgjegjësi për të vepruar në përputhje me Kodin e Sjelljes për Mediat Elektronike përsa i përket të gjitha programeve që ai mund të transmetojë, pavarësisht nga burimi origjinal i një programi të tillë.

**3.8 Mundësia për përgjigje:** Kur ndodhin shkelje flagrante të kësaj Licence ose të rregulloreve ose ligjeve në zbatim, KPM-ja do të sigurojë plotësisht dhe në mënyrë të paanshme mundësinë për tu dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve për shkeljet.

### **3.9 Kësaj Licence i bashkangjiten për referim ligjor dokumentet ligjore të mëposhtme:**

- (a) Kodi i Sjelljes për Mediat Elektronike i KPM-së dhe dokumentet ligjore që lidhen me të e që janë nxjerrë nga KPM-ja;
- (b) Pjesët 1, 2, 3 dhe 4 të Licencës së KPM-së;
- (c) Rregullat zgjedhore për media siç mund të shpallen nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve;
- (d) Rregullorja e UNMIK-ut 2000/36.

## **4.0 Dispozita për Veprimtarinë**

### **4.1 Detyrimet për të Drejtën e Autorit:**

4.1.1 Të Licencuarit i kërkohet të veprojë në përputhje me ligjin në zbatim në Kosovë për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, nuk kërkohet një leje e tillë.

4.1.2 I Licencuari bije dakort që t'i sigurojë KPM-së kopje të marrëveshjeve për këto leje brenda tri (3) ditëve nga kërkesa me shkrim.

### **4.2 Mbajtja e Arkivës:**

4.2.1 Emetuesit e radios duhet të mbajnë arkivë 21 ditëshe të të gjitha programeve të transmetuara, në kaseta magnetofoni ose në format digjital ekuivalent.

4.2.2 Emetuesit e televizionit duhet të mbajnë arkivë 21 ditëshe të të gjitha programeve të transmetuara, në kaseta VHS ose në format DVD.

### **4.3 Informacioni i të Licencuarit që kërkohet t'ia jap KPM-së:**

4.3.1 I licencuari duhet që brenda pesë ditëve të punës të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme, dhe të gjitha këto do të trajtohen nga KPM-ja si çështje të dhënash publike:

- (a) Çdo ndryshim në gjendjen e individëve, zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që kanë Licencë të KPM-së ose pronësi të një pjese të saj që mund të çojë në skualifikimin e tyre për marrjen e licencës duhet ti raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve të punës nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i skualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur u bë për skualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çregullimit të operimit të emetuesit.
- (b) Të dhënat e adresës së Stacionit, telefoni, faksi ose informacione të tjera kontakti;

- (c) Shënime të informacionit teknik siç kërkohet nga njoftimi në Pjesën II të Licencës së KPM-së;
- (d) Menaxhmentin Kryesor (Zyrtarët e lartë), përfshirë drejtorin e stacionit, drejtorin e lajmeve dhe drejtorin teknik;
- (e) Identiteti i pronarëve të rradhitur në kërkesën për licencë që zotërojnë më pak se 10% të aksioneve të një emetuesi që është regjistruar si shoqëri aksionere (Ndryshimet me 10% e lart kërkohen miratim paraprak të KPM-së në përputhje me paragrafin 5.2 të Pjesës 1);
- (f) Identiteti i drejtorëve të OJQ-së që themelon një të Licencuar;
- (g) Ndryshime të mëdha në orët e operimit;
- (h) Ndërprerje të transmetimit më të mëdha se programi i planifikuar i një dite të plotë.

**4.4 Fillimi i Transmetimit:** Përveç rasteve kur përjashtohet nga ky detyrim nga KPM-ja, i Licencuari duhet të fillojë veprimtarinë transmetuese dhe të pajtohet me kushtet dhe termet e licencës brenda 90 ditëve nga marrja e licencës ose një amendament të saj. Neglizhimi i të vepruarit në përputhje me këtë kërkesë mund të çojë në anulimin e licencës ose të amendamentit të saj.

**4.5 Koha e transmetimit:** Përdorimi i licencuar i një frekuence lejohet 24 orë në ditë, në të shtatë ditët e javës përveç rasteve kur kufizohet nga Kushtet dhe Termet Specifike të Licencës. Përveç rasteve kur përjashtohet nga ky detyrim nga KPM-ja, i Licencuari duhet të transmetojë minimalisht gjashtë orë në ditë, në shtatë ditët e javës, ndërmjet orës 06:00 dhe 24:00.

**4.6 Përdorimi i Shërbimeve të Transmetimit:** I Licencuari mund të kontrakttojë me një organizatë shërbimesh teknike të aprovuar nga KPM-ja me qëllim që të vëjë në funksion dhe të mirëmbajë transmetuesit dhe lidhjet në emër të të Licencuarit. Në këto raste, i Licencuari duhet ruajë plotësisht të drejtat dhe detyrimet e Licencës.

#### **4.7 Identifikimi i Stacionit:**

4.71 I Licencuari për radio duhet ta identifikojë veten gjatë emetimit qartë dhe në vazhdimësi me anë të emrit të tij të autorizuar së paku një herë në çdo 60 minuta transmetimi.

4.72 I Licencuari për televizion duhet ta identifikojë veten gjatë emetimit qartë dhe në vazhdimësi me anë të emrit të tij të autorizuar së paku një herë në çdo 60 minuta transmetimi, dhe duhet të mbajë një shenjë të veçantë identifikimi në ekran gjatë gjithë programit, me përjashtim të reklamave komerciale.

4.73 I Licencuari që ritransmeton programe të prodhuara nga organizata të tjera emetuese duhet që të identifikojë qartë dhe në vazhdimësi burimin e programit të ritransmetuar.

#### **4.8 Praktikrat e mbrojtjes së shëndetit:**

- 4.8.1 I Licencuari duhet t'i vë në funksionim të gjitha sistemet dhe objektet e transmetimit përta i përket mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe të publikut në përgjithësi, në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.
- 4.8.2 Strukturat e antenave duhet të jenë konform standardeve të përgjithshme Evropiane të pranuara për sigurinë e konstruksionit dhe të mirëmbajtjes, përfshirë përdorimin e dritave që duhen për sinjalizimin e mjeteve fluturuese, në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.
- 4.8.3 I Licencuari në përshtatje me porositë dhe njoftimet për përdorim të përgjithshëm që mund të nxjerrë KPM-ja për të siguruar informimin e publikut për Licencën e tij, ankesat me shkrim, pronësinë ose dokumenta të tjera që lidhen me veprimtarinë e stacionit, që KPM-ja mund konsiderojë se janë me interes publik.

**4.9 Ndërprerjet e Transmetimit:** Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit në veprimtarinë e transmetimit të të Licencuarit do të bëjnë që nga ana e KPM-së të rishikohen rrethanat dhe mund të çojnë në anulimin e Licencës.

**4.10 Paguesa për Licencën:** I Licencuari duhet që, për dhënien e Licencës t'i paguaj KPM-së një pagesë për Licencën në përshtatshmëri me tarifrat dhe programet që do të specifikohen nga KPM-ja.

#### **4.11 Formati i Programit:**

- 4.11.1 Në bazë të kërkesave të Paragrafit 2.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 që KPM-ja duhet t'i merr parasysh interesat publike në dhënien e licencave të transmetimit, nga i Licencuari pritet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit iu dha Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Moskryerja e kësaj mund të çojë në anulimin e Licencës.
- 4.11.2 Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë KPM-në paraprakisht për propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin në kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me to.

#### **5.0 Përdorimi dhe Transferimi i Licencës:**

**5.1 Karakteri i Licencës:** Kjo Licencë është një dhënie e kushtëzuar e lejes nga ana e KPM-së për të përdorur një ose më shumë frekuenca specifike transmetimi siç përcaktohet në Standardet Teknike, kushtet dhe Referencat e kësaj Licence. Licenca nuk bart pronësinë mbi frekuencën.

**5.2 Transferimi ose Dorëzimi i Licencës:** I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë ose frekuenc-ën(at) e përcaktuara të saj pa miratimin paraprak me



shkrim të KPM-së. Çdo Ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të Licencuarit do të kërkojnë paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së. Kjo kërkesë do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimit të drejtimit të të licencuarit që është regjistruar si OJQ, në përputhje me Rregulloren e KPM-së për Cilësitë për marrje Licence. Në asnjë rrethanë nuk do të paguhet e as të pranohet asnjë kompensim financiar për transferimin e kësaj licence, në rastin kur këtë leje transferimi e jep KPM-ja.

**5.3 Kontrolli Efektiv i Frekuencës:** I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë plotësisht ose pjesërisht pa një autorizim specifik paraprak me shkrim nga ana e KPM-së. Në asnjë rrethanë nuk do të paguhet ose pranohet shpërblim financiar për transferimin e kësaj licence, në rastin kur leja për transferimin është dhënë nga KPM-ja.

**5.4 Leja për transferimin:** KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individit ose organizatë të cilët propozohen që tu transferohet licenca plotësojnë standardet e KPM-së për tu dhënë një licencë. KPM-ja mund, në bazë të të drejtave të saj, të kërkojë që çdo transferim i një licence tek një pronësi e re t'i nënshtrohet një shqyrtimi publik dhe/ose një tenderi publik për të siguruar që një transferim i tillë i shërben plotësisht interesave publike.

**5.5 Vdekja ose paaftësia e të Licencuarit:** Në rast se i Licencuari, që është një individ, vdes ose bëhet i paaftë, ose i Licencuari si organizatë ndërpret veprimtarinë, shpërbëhet ose deklarohet i falimentuar nga një autoritet kompetent, KPM-ja mund ta përfundojë Licencën ose t'ia transferojë Licencën një pasardhësi të kualifikuar. Licenca nuk do të trajtohet si kapital themelor ose pronësi që është objekt i një likuidimi financiar ose trashëgimie.

## **6.0 Ndryshimet e Licencës:**

**6.1 Kërkesa për të ndryshuar licencën:** Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Paragrafin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuar në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.

**6.2 Ndryshimet e KPM-së në licencë:** Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Referencat, të licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në përputhje me Rregulloren 2000/36, duke u siguruar që këto ndryshime ishin shumë të nevojshme për të siguruar një përdorim më të rregullt të spektrit të frekuencës dhe i Licencuari kishte një mundësi të arsyeshme që të bënte paraqitjen para KPM-së përpara i përket ndryshimeve të propozuara.

## **7.0 Sanksionet për Mosplotësimin e Licencës dhe Rregulloreve të KPM-së:**

**7.1 Sanksionet e zbatueshme:** Shkelja e kushteve dhe termeve të kësaj Licence ose dokumentave ligjore që e shoqërojnë atë mund të çojnë në një ose më shumë nga sanksionet e mëposhtme të specifikuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/36:

- (a) Të kërkojë të transmetohet një korrigjim ose shfajësim;
- (b) Një paralajmërim;
- (c) Një gjobë jo më të vogël se 1,000 DM [Euro 500] dhe jo më të madhe se 100,000 DM [Euro 50,000];
- (d) Pezullimin e licencës së transmetimit;
- (e) Heqjen e të drejtës për të hyrë në godina;
- (f) Konfiskimin e pajisjeve;
- (g) Ndalimin e veprimtarisë transmetuese; ose
- (h) Mbarimin e licencës së transmetimit.

**7.2 Konfiskimi i Pajisjeve:** I Licencuari bie dakort me kushtet e mëposhtme që lidhen me konfiskimin e pajisjeve të transmetimit në bazë të Paragrafit 3.1(f) të Rregullores 2000/36:

7.2.1 Në rastin kur i Licencuari zëvendëson pajisjet e konfiskuara pa autorizimin me shkrim të KPM-së, këto veprime të paautorizuara do të përbëjnë kundërvajtje materiale të kushteve të licencuara të transmetimit, që mund të çojë në anulimin e menjëhershëm dhe të përhershëm të licencës së transmetimit;

7.2.2 Në rastin e konfiskimit të pajisjeve të transmetimit në bazë të Paragrafit 3.1(f) të Rregullores 2000/36, KPM-ja do ti jep të Licencuarit një vërtetim për të gjitha pajisjet e konfiskuara. Në pritje të vendimit përfundimtar të Bordit të Mediave për Ankesa, pajisjet e konfiskuara do të mbeten vetëm në ruajtje të KPM-së. KPM-ja mban përgjegjësi të plotë për pajisjet gjatë kohës që ato janë në ruajtje tek KPM-ja.

**7.3 Pezullimi ose Anulimi i Licencës:**

7.3.1 Në rastin kur KPM-ja jep sanksionin 7.1 (e), (f), (g) ose (h) kundër të Licencuarit duke kërkuar pezullimin e transmetimit anulimin e autorizimit për transmetim të të Licencuarit, përveç rasteve kur është shpallur gjendje e jashtëzakonshme nga PSSP-ja ose ndonjë autoritet tjetër i autorizuar me Ligj për të deklaruar gjendje të jashtëzakonshme, sanksioni nuk do të jetë në veprim deri sa Bordi i Mediave për Ankesa të jep përcaktimin përfundimtar. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, i Licencuari i urdhëruar që të pezullojë transmetimin duhet ta zbatojë këtë gjë menjëherë pas marrjes së një urdhëri të tillë nga KPM-ja. Mos vënia në zbatim e tij mund të çojë në anulimin e licencës.

7.3.2 I Licencuari merr njoftim dhe pranon që shkelja e kushteve dhe termeve të kësaj Licence, si dhe kushteve dhe termeve të dokumentave ligjore të cituara në 3.10, iu nënshtrohet sanksioneve të rradhitura në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/36 dhe këtu, duke përfshirë edhe anulimin e Licencës nëse këto shkelje konsiderohen kundërvajtje të rënda të kësaj marrëveshjeje për Licencën.

**8.0 Forca Madhore:**

**8.1 Marrja në konsideratë e Forcës madhore:** Në vlerësimin e neglizhimit të të Licencuarit për të vepruar sipas kushteve dhe termeve të Licencës së tij, KPM-ja do të merr parasysh të gjitha rrethanat e rënda dhe të pakontrollueshme nga një *forcë madhore*, siç janë nxjerrja jashtë nga objektet, zjarri, eksplozimi ose trazira sociale.

**8.2 Mos-zbatimi i tarifave të licencës:** Rrethanat e radhitura në Paragrafin 8.1 nuk do të përdoren për të justifikuar pezullimin e pagimit të pagesave të licencës që duhen paguar. Si dhe avari të vogla të pajsjeve që nuk ndikojnë në funksionimin e stacionit nuk do të interpretohen si *forcë madhore*.

## **9.0 Gjuha:**

9.1 Në rast konflikti, përsa i përket interpretimit të kësaj Licence, versioni në gjuhën Angleze do të jetë dominues.

---

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pjesën I të kësaj Licence, përfshirë dhe aderimin me Kodin e Sjelljes për Mediat Elektronike.*

EMRI:

DATA:

NËNSHKRIMI:

Për të Licencuarin:

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, kjo licencë do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.*

**EMRI:**

**DATA:**

**NËNSHKRIMI:**

**VULA**

[Miratuar më: 25 prill 05]



## Part 2: Technical Terms and Conditions of License

### Pjesa 2: Standardet Teknike dhe Kushtet e Licencës

#### Odeljak 2: Tehnicki Standardi i Uslovi Dozvole

*This document constitutes an integral part of the TMC broadcast license  
Ky dokument përbën një pjesë integrale të lejes transmetuese të lëshuar nga KPM  
Ovaj dokument čini integralni deo dozvole za emitovanje PKM*

<b>Licensee :</b> <b>Marrësi i Lejes:</b> <b>Primalac Dozvole:</b>	<b>Index:</b> <b>Indeksi:</b> <b>Indeks:</b>
--	--

1	<input type="checkbox"/> Name of Director <input type="checkbox"/> Emri i Drejtorit <input type="checkbox"/> Ime Direktora		
2	<input type="checkbox"/> Address of Record <input type="checkbox"/> Adresa e subjektit transmetues <input type="checkbox"/> Broj zabeleške		As stated in license records Si është e cekur në të dhënat per leje Kao što je upisano u belešci o dozvoli
3	<input type="checkbox"/> Office Telephone <input type="checkbox"/> Telefoni i zyrës <input type="checkbox"/> Telefon u kancelariji		Office telephone(s). Numrat e telefonit në zyrë Broj(evi) telefona u kancelariji
4	<input type="checkbox"/> Office Fax <input type="checkbox"/> Faxi i zyrës <input type="checkbox"/> Telefaks kancelarije		Office telephone(s). Numrat e telefonit në zyrë Broj telefaksa u kancelariji

5	<p>☞ Emergency Contact Information</p> <p>☞ Numër për informata emergjente</p> <p>☞ Informacije o kontaktu u hitnim slučajevima</p>		<p>--Mobile or other telephone number in event of urgent inquiries related to transmitter operations.</p> <p>--Numri mobil apo ndonjë numër tjetër telefoni për informata urgjente në lidhje me operimet e transmetuesit.</p> <p>--Broj mobilnog ili drugog telefona za pitanja u hitnom slučaju, vezano za rad predajnika</p>
6	<p>☞ Technical Director</p> <p>☞ Drejtori teknik</p> <p>☞ Tehnicki direktor</p>		<p>Name of person responsible for transmitter operations</p> <p>Emri i personit për operimet e transmetuesit</p> <p>Lice odgovornog za rad predajnika</p>
7	<p>☞ Owner of studio facilities if other than Licensee</p> <p>☞ Pronari i pajisjeve të studios, nëse është dikush tjetër pos marrësit të lejes</p> <p>☞ Vlasnik studijskih prostorija, ukoliko je drugaciji od korisnika dozvole</p>		
8	<p>☞ Transmitter Identity</p> <p>☞ Të dhëna për transmetuesin</p> <p>☞ Podaci predajnika</p>		<p>Transmitter Call-Sign</p> <p>Shifra e transmetuesit</p> <p>Šifra predajnika</p>
9	<p>☞ Manufacturer and Model Number of Transmitter</p> <p>☞ Numri i prodhimit dhe modelit të transmetuesit</p> <p>☞ Proizvodjac i broj modela predajnika</p>		
10	<p>☞ Frequency of transmitter</p> <p>☞ Frekuenca e transmetuesit</p> <p>☞ Frekvencija predajnika</p>		<p>MHz for radio</p> <p>MHz për radio</p> <p>MHz za radio stanicu</p>

11	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Transmitter Channel Number</li> <li>☞ Numri i kanalit të transmetuesit</li> <li>☞ Broj kanala predajnika</li> </ul>		<p>For television: Normal broadcast number.</p> <p>Për televizion: numri normal i Transmetimit</p> <p>Za televiziju: standardni broj Emitovanja</p>
12	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Transmitter output power</li> <li>☞ Fuqia dalëse e transmetuesit</li> <li>☞ Izlazna snaga predajnika</li> </ul>		<p>Watt</p> <p>Vat</p> <p>Vat (W)</p>
13	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Maximum Operating ERP (Effective Radiated Power)</li> <li>☞ Fuqia maksimale e ERP-së (Fuqia Efektive Transmetuese)</li> <li>☞ Maximalna radna ERP (Efektivna snaga predajnika)</li> </ul>		<p>Watt</p> <p>Vat</p> <p>Vat (W)</p>
14	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Location of Transmitter</li> <li>☞ Vendi i transmetuesit</li> <li>☞ Mesto predajnika</li> </ul>		<p>City or village</p> <p>Qytet apo fshat</p> <p>Selo ili grad</p>
15	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Facility in which transmitter is located</li> <li>☞ Vendi në të cilin është vendosur transmetuesi</li> <li>☞ Objekat u kome je predajnik smešten</li> </ul>		<p>Separate building or building shared with other facilities.</p> <p>Ndërtesë e veçantë apo ndërtesë e përbashkët me pajisjet tjera.</p> <p>Posebni objekat ili objekat koji se deli sa drugim uredajima.</p>

16	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Geographic Coordinates of Transmitter</li> <li>☞ Koordinatat gjeografike</li> <li>☞ Geografske koordinate predajnika</li> </ul>		<p>Standard geographic coordinates of transmitter (latitude and longitude) WGS 84</p> <p>Koordinatat gjeografike standarde të transmetuesit (gjerësia dhe gjatësia) WGS 84</p> <p>Standardne geografske koordinate predajnika (dužina i širina) WGS 84</p>
17	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Source of Program Feed to Transmitter</li> <li>☞ Burimi i emetimit të programit deri tek transmetuesi</li> <li>☞ Izvor programskog napajanja do predajnika</li> </ul>		<p>Line, MHz or GHz</p> <p>Lidhje në MHz apo GHz</p> <p>Liniski, MHz ili GHz</p>
18	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Maximal Deviation of signal</li> <li>☞ Devijimi më i madh i sinjalit</li> <li>☞ Maksimalna devijacija signala</li> </ul>		<p>kHz</p> <p>kHz</p> <p>kHz</p>
19	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Type and number of Transmitting Antenna</li> <li>☞ Lloji dhe numri i antenës transmetuese</li> <li>☞ Tip i broj predajnicke antene</li> </ul>		
20	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Altitude of Antenna Site</li> <li>☞ Lartësia e pozitës së antenës</li> <li>☞ Nadmorska visina mesta gdje je antena postavljena</li> </ul>		<p>Meters above sea level.</p> <p>Sa metra lartësi mbidetare</p> <p>Metara iznad nivoa mora</p>
21	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Height of the transmitting antenna</li> <li>☞ Gjatësia e antenës transmetuese</li> </ul>		<p>Height above ground level.</p> <p>Lartësi mbi nivelin e tokës</p> <p>Visina iznad površine zemlje</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Visina predajnicke antene</li> </ul>		
22	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Antenna Polarization</li> <li>☞ Polarizimi i antenës</li> <li>☞ Polarizacija antene</li> </ul>		<p>Horizontal, Vertical, Mixed, Circular.</p> <p>Horizontal, vertikal, e përzier apo rrethore.</p> <p>Horizontalna, Vertikalna Mešovita , Kružna</p>
23	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Transmitting Antenna Gain</li> <li>☞ Shtesa e antenave emetuese</li> <li>☞ Antensko pojacanje prenosne antene</li> </ul>		<p>If directional, gain in direction of major lobe.</p> <p>Nëse është dirkete, shtesa në drejtim të antenës kryesore.</p> <p>Ukoliko je usmeren, pojacanje u pravcu glavne antene</p>
24	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Direction of Antenna Major Lobe</li> <li>☞ Drejtimi i antenës kryesore</li> <li>☞ Pravec glavnog vrha antene</li> </ul>		<p>Degrees</p> <p>Shkallë</p> <p>Stepeni</p>
25	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Antenna Major lobe Angle of Elevation (tilt)</li> <li>☞ Antena kryesore, këndi i ngritjes</li> <li>☞ Antenski ugao skretanja glavnog vrha</li> </ul>		<p>Degrees</p> <p>Shkallë</p> <p>Stepeni</p>
26	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Operating standard of studio equipment</li> <li>☞ Standardet operuese të pajisjeve të studios.</li> <li>☞ Radni standard studijske opreme</li> </ul>		<p>Television Only</p> <p>Vetëm për televizion</p> <p>Samo za Televiziju</p>



**NOTE 1:** Stations may change items 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 15, 17 and 26 at will, but must notify TMC of any such changes within five (5) days. Failure to do so may result in penalties.

**NOTE 2:** Stations may NOT change items; 11, 12, 13, 14, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 and 27 without prior written approval from TMC. Failure to comply with this requirement may cause broadcast interference and may result in serious penalties.

**NOTE 3:** Item 12, Transmitter Power, is the maximum power at which this licensed transmitter may be operated. Effective Radiated Power, referenced in Item 13 is a term combining approved transmitter power and antenna characteristics which together determine broadcast coverage area.

---

**VËREJTJE 1:** Stacionet transmetuese mund të ndryshojnë vetë specifikat e dhëna nën pikat: 1,2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 15, 17 dhe 26 mirëpo duhet ta lajmërojnë KPM-në për ato ndryshime brenda pesë (5) ditëve. Mospërbushja e këtij obligimi mund të rezultojë në dënim.

**VËREJTJE 2:** Stacionet transmetuese NUK mund të ndryshojnë specifikat e dhëna nën 11, 12, 13, 14, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, dhe 27 pa marrë më parë aprovimin me shkrim nga KPM-ja. Mospërbushja e kësaj kërkesë mund të shkaktojë ndërhyrje në transmetim dhe mund të rezultojë në dënime serioze.

**VËREJTJE 3:** Pika 12, Fuqia Dalëse e Transmetuesit, është fuqia maksimale në të cilën ky transmetues i licencuar mund të punojë. Fuqia Efektive Transmetuese, që është dhënë nën 13 është term që kombinon fuqinë e aprovuar të transmetuesit dhe karakteristikat e antenës, që së bashku përcaktojnë rajonin e mbuluar me transmetim.

---

**NAPOMENA 1:** Stanice mogu promeniti stavke 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 15, 17 i 26 po želji, sa obavezom da obaveste PKM u roku od 5 (pet) dana. Neizvršavanje može rezultovati kaznama.

**NAPOMENA 2:** Stanice NE smeju menjati stavke 11, 12, 13, 14, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 i 27 bez prethodnog pismenog odobrenja od strane PKM-a. Neizvršenje ovog zahteva može dovesti do smetnji u emitovanju i može rezultovati ozbiljnim kaznama.

**NAPOMENA 3:** Stavka 12, Snaga predajnika, je maksimalna snaga pod kojom ovaj predajnik može raditi. Vrednost emitovane sna ge, korišćen u stavku 13, je term koji kombinuje snagu predajnika i karakteristike antene i koji zajedno utvrduju radiodifuznu pokrivenost mesta.

---



KOMISIONERI I PËRKOQSHËM PËR MEDIA  
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE  
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

**Section 27: Additional Terms of License:**

**Sekcioni 27: Kushtet Shtesë të Licencës**

**Sekcija 27: Dodatni uslovi za Dozvolu:**

<p><b>Ownership :</b></p>          <p><b>Others :</b></p>
---

Place/Vendi/Mesto

Place/Vendi/Mesto

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Date/Data/Datum

Date/Data/Datum

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Signed for TMC  
Nënshkruar për KPM  
Potpisao za PKM

Signed for Station  
Nënshkruar për stacionin  
Potpisao za stanicu

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



## PJESA 3 E LICENCËS SË KPM-së – FORMATI I PROGRAMIT

**Emri i Stacionit:**

**Indeksi i Medias:**

**I Licencuari:**

**Data:**

- 
- 1.0 Në bazë të kërkesës së Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 që KPM-ja të merr për bazë interesat e publikut me rastin e dhënies së licencave të transmetimit, nga i Licencuari pritet që në transmetimet e tij, si një nga kushtet e Licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe spektri i frekuencës. Neglizhimi i shpesh të zbatimit të tij mund të çojë në anulimin e Licencës.
- 2.0 Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t'i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave u dha Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 në përputhje me to.
- 2.1 Si ndryshim i rëndësishëm që kërkon informimin paraprak të KPM-së përcaktohet ndryshimi i një të katërtës të ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit, ose eliminimi i ndonjëres nga kategoritë e Tabelës 1; dhe/ose një ndryshim material në llojin dhe përmbajtjen e programit siç është përcaktuar në Tabelën 1. Ndryshime të tilla do të maten me krahasimin me sasinë e tipeve të programit dhe burimeve, dhe formatin, siç është përcaktuar në kërkesën origjinale të të Licencuarit.

### 3.0 Përkufizime:

- 3.1 Programi i Shërbimit Publik:** Programi i Shërbimit Publik përbëhet nga lajmet, diskutimet dhe intervistat për çështjet me interes publik; programet edukative aktuale për të rriturit ose fëmijët që kanë nevojë për përkrahje ose ndryshojnë bindje për tema ose modele; argëtime për fëmijë me tema edukative; dokumentarët; programet kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë e jo të argëtojnë.
- 3.2 Programe Argëtuese:** Muzikë popullore/bashkëkohore, filma, lojëra, sport, drama dhe komedi komerciale dhe programe që lidhen me to.
- 3.3 Programe të Prodhimit të Vet:** Shfaqje ose paketa programore që përfshijnë materiale argëtuese dhe ato të shërbimit publik të prodhuar dhe të paraqitur nga i Licencuari.
- 3.4 Programe të Ritransmetuara:** Shfaqje ose paketa të tjera programesh të siguruara nga transmetues të tjerë vendas ose të huaj, zakonisht me satelit dhe të ritransmetuara nga i Licencuari në bazë të kontratës me prodhuesin ose emetuesin e parë.

**3.5 Programe Komerciale nga Jashtë:** Programe të marra në bazë të një kontrate të vlefshme komerciale, zakonisht në formë të regjistruar, siç janë filmat.

TABELA 1

<b>1. Tipi i programit</b>	Përqindja
1.1 Shërbimi Publik	
1.2 Argëtim:	
	Gjithsej %
<b>2. Burimi i Programit</b>	
2.1 Prodhim i veti	
2.2 Komercial nga jashtë	
2.3 Ritransmetim	
	Gjithsej %

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pjesën 3 të kësaj Licence.*

**EMRI:**

**DATA:**

**NËNSHKRIMI:**

**I LICENCUARI:**

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, Pjesa 3 e kësaj Licence do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.*

**NËNSHKRIMI:**

**DATA:**

[Miratuar më: 25 prill 2005]



KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA  
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE  
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

## **PJESA 4 E LICENCËS SË KPM-së – HARTA E ZONËS SË LICENCUAR**

**Emri i stacionit:**

**Indeksi i Medias:**

**I licencuari:**

**Data:**

---

### **1.0 Përkufizime:**

- 1.1 Harta e Zonës së Licencuar (HZL) përcaktohet si një ose më shumë harta topografike të përgatitura nga KPM-ja për të shënuar kufijtë fizikë në Kosovë të cilat i Licencuari autorizohet t'i mbulojë sipas kushteve dhe termeve teknike të përshkruara hollësisht në Pjesën 2 të Licencës.
- 1.2 HZL-ja do t'i jepet të licencuarit në formë të shtypur dhe si figurë digjitale.

### **2.0 Krite bazë të Vijës kufitare në Hartën e Zonës së Licencuar:**

- 2.1. Vija kufitare e HZL-së është një vijë që përcakton kufirin me një sinjal me fuqi prej 48 dB mikrovolt/m<sup>2</sup> për FM radio dhe 65-70 dB mikrovolt/m<sup>2</sup> për televizion UHF që shënohet në kufirin e jashtëm të zonës së kuqe të hartave të KPM-së. Kjo vijë kufitare cakton kufirin përtej të cilit nuk duhet të shkaktohen ndërhyrje në zonën e mbulimit të stacioneve fqinjë që operojnë në të njëjtën frekuencë.

### **3.0 Veprime të të Licencuarit brenda Hartës së Zonës së Licencuar:**

- 3.1 I Licencuari mund të kërkojë të përmirësojë mbulimin zonal brenda HZL-së që i është caktuar atij, duke përdorur transmetues shtesë. Megjithatë, çdo transmetues i tillë shtesë kërkon miratim të veçantë të KPM-së para instalimit dhe vënies në funksion të tyre. KPM-ja do të mundohet që kërkesave të tilla tu japë në kohë përgjigje të favorshme, duke siguruar që një ndryshim i tillë të mos ketë pasoja në Hartën e Zonës së Licencuar.

#### **4.0 Ndryshimi i Hartës së Zonës së Licencuar:**

4.1 I Licencuari nuk mund ta ndryshojë HZL-në e tij pa miratim paraprak me shkrim të KPM-së. KPM-ja do të miratojë ndryshime të tilla vetëm kur konstaton se ky veprim bëhet për interesa publike.

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pjesën 4 të kësaj Licence.*

**EMRI:**

**DATA:**

**NËNSHKRIMI:**

**I LICENCUARI:**

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, Pjesa 4 e kësaj Licence do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.*

**NËNSHKRIMI:**

**DATA:**

[Miratuar më 25 prill 2005]